

SOT I JEPET LAMTUMIRA E FUNDIT BABAIT TË HASHIM THAÇIT

FAQE 3

Sot (e martë) do t'i jepet lamtumira e fundit babait të ish-presidentit Hashim Thaçi, Haxhi Thaçi, i cili ka ndërruar jetë të dielën në moshën 87-vjeçare. Para ceremonisë së varrimit, e cila është planifikuar të mbahet në orën 15:00 në fshatin Burojë, në palestrën “Ilaz Kodra” në Skenderaj do të bëhen homazhe pranë arkivolit të tij dhe do të mbahet një mbledhje përkujtimore kushtuar bacës Haxhi. Familja e Thaçit do të mbajë tri ditë të pame në palestrën “Ilaz Kodra” në Skenderaj, ndonëse nga hëna janë hapur dyert për ngushëllime, ku në Burojë kanë shkuar liderë të institucioneve, të partive dhe qytetarë të shumtë

OPINION

RRUGË E MBARË PËR NË PARAJSË, HAXHI THAÇI!

F. 8

Behxhet Sh. SHALA - BAJGORA

AKTUALE

SORENSEN: KOMPROMISET NË DIALOG I PËRCAKTOJNË PALËT

F. 3

VETËVENDOSJE KUNDËR REZULTATEVE PËRFUNDIMTARE TË ZGJEDHJEVE, ANKOHET NË PZAP

F. 3

FSK-ja NIS OPERACIONIN HUMANITAR PËR PASTRIMIN E FUSHAVE TË MINUARA

F. 6

ZJARRI NË KOÇAN: TË LËNDUARIT ME DJEGIE TË RËNDA DËRGOHEN NË GJASHTË VEND TË HUAJA

F. 2

EKONOMI

ODA EKONOMIKE KËRKON SHTYRJEN E VENDIMIT PËR SHITRENJTIMIN E RRYMËS

F. 8

A MUND TË NDALEN KUSARËT E ZRRE-së?! -REAGIM I KMDLNJ-së

f. 8

RENOVA

PUTZ

Maqedoni

Xhepçisht -Tetovë

Gurëz-Ferizaj

Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009

+389 44 487 755

Fax: +389 44 487 200

Mob: +377 44 501 289

E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA GROUP SH.P.K.

NDËRTIM PROJEKTIM SHITJE

INFO: 049-111-101,

044-511-177

www.princesha-ks.com

Bunjamini

FABRIKA E LLAQEVE

044/256-051

044/367-061

028/532-617

MITROVICË

STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI

www.kolegji.biznesi.com

info@kolegji.biznesi.com

030 500 878 | 045 500 878

044 500 878 | 049 500 878

SIGMA

VIENNA INSURANCE GROUP

SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A

DEGA KOSOVË

Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,

Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,

E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY

Digital Agency

Endrit Shaqiri

+38344685122

Internet Website, Marketing...

Trumpi dhe Putini pritet të diskutojnë sot për Ukrainën

FLORIDA, 17 MARS - Donald Trump ka njoftuar se do të flasë sot (e martë) me presidentin rus Vladimir Putin, ndërsa ai kërkon t'i japë fund luftës në Ukrainë. Udhëheqësi amerikan ka zbuluar këtë lajm për gazetaret, ndërsa fluturonte nga Florida në

Uashington me "Air Force One", shkruajnë mediet e huaja. "Ne do të shohim nëse kemi diçka për të shpallur ndoshta deri të martën. Unë do të flas me presidentin Putin të martën. Shumë punë është bërë gjatë fundjavës. Ne duam të shohim

nëse mund t'i japim fund asaj lufte", citohet të ketë thënë Trumpi. Edhe pse Rusia ka dështuar në qëllimin e saj fillestar për ta "rrëzuar" Ukrainën me pushtimin e saj tre vjet më parë, ajo ende kontrollon zona të

mëdha të vendit. Dhe Trumpi ka thënë se toka dhe termocentralet janë pjesë e bisedës rreth përfundimit të luftës. "Ne do të flasim për tokën. Do të flasim për termocentralet", tha ai, duke e përshkruar atë si "ndarje të



aseteve të caktuara", ka thënë presidenti amerikan.

Zjarri në Koçan: Të lënduarit me djegie të rënda dërgohen në gjashtë vend të huaja

SHKUP, 17 MARS - Gjithsej 84 pacientë nga zjarri në një klub nate në jug të Maqedonisë së Veriut janë duke u mjekuar në spitalet e Shkupit, ndërsa 51 të lënduarit e tjerë janë dërguar jashtë vendit për shërim, njoftoi ministri i Shëndetësisë, Arben Taravari. Sipas tij, pacientët në përgjithësi janë në gjendje të qëndrueshme. Mjekët po luftojnë për shëndetin e të lënduarve një ditë pas tragjedisë në klubin e natës "Pulse" në Koçan, ku 59 të rinj të vdiqën nga zjarri dhe të paktën 155 u plagosën. "Kam shokë që kanë vdekur dhe shumë të cilët janë lënduar dhe tani janë në spital në Shkup. Disa janë në gjendje kritike, disa jo", tha Sara për Radion Evropa e Lirë, një 14-vjeçare, e cila sot ishte në qendër të Koçanit për t'i nderuar viktimat e zjarrit. Ministria e Shëndetësisë e Maqedonisë së Veriut e pranoi ndihmën e ofruar nga shtetet e huaja për t'u kujdesur për të lënduarit. Deri më tani, 51 persona të lënduar janë dërguar për trajtim në gjashtë vende të ndryshme. Fatmirësisht pacientët që u sollën dje në spitalet në mbarë vendin janë në gjendje stabile. Dhe ata që u transferuan jashtë vendit janë të gjithë në gjendje përgjithësisht stabile, tha ministri Taravari në një konferencë për medie më 17 mars.

Njëzet nga të lënduarit që u dërguan për mjekim jashtë vendit janë në gjendje të rëndë. Sipas Taravarit, të lënduarit janë transportuar jashtë vendit jo sepse vendi nuk ka qendër djegieje, por për shkak se ka pasur një numër të madh të pacientëve. "Kemi përjetuar tronditje, djegie të më shumë se njëqind personave që duhet të trajtohen dhe është normale që nuk kemi kapacitet për t'i trajtuar mirë. Këta pacientë, për shkak të komplikimeve që vijnë nga djegiet, dhe që të gjithë janë të shkallës së dytë apo të tretë tashmë, janë në rrezik infektimi dhe synimi ynë ka qenë që t'i trajtojmë sa më mirë", ka thënë ai.

Ku janë dërguar të lënduarit?

Në spitalet e Koçanit dhe Shtipit nuk janë duke u trajtuar më pacientë nga zjarri i Koçanit. Në Qendrën Klinike në Shkup janë duke u mjekuar 49 të lënduar, 18 në Spitalin e Përgjithshëm "8 Shtatori" dhe 17 të tjerë në Spitalin Kirurgjik "Shën Naum Ohërski". Nëntë pacientë janë dërguar në Turqi dhe janë përgjithësisht në gjendje të qëndrueshme, sipas Taravarit. Në Bullgari janë dërguar 14 pacientë. Në Greqi po trajtohen pesë pacientë. 17 persona të lënduar janë dërguar



në Serbi. Një vajzë dhe një djalë, të dy rreth 20 vjeç, u dërguan në Budapest të Hungarisë. Katër pacientë janë dërguar në Lituanë. Më shumë persona të lënduar do të dërgohen sot në spitalet e huaja - dy në Slloveni, katër në Kroaci dhe gjashtë në Austri. Dymbëdhjetë pacientë të tjerë do të dërgohen me avion në Akademinë Mjekësore Ushtarake (MMA) në Beograd të Serbisë, bëri me dije Taravari. "Situata është plotësisht nën kontroll. Presim që të ketë sa më pak komplikime", nënvizoi Taravari. Qytetarët maqedonas që jetojnë jashtë vendit kanë ofruar në rrjetet sociale ndihmë dhe akomodim për familjarët e të plagosurve. Ministri i Punëve të Jashtme,

Timço Mucunski, ka njoftuar se do të propozojë që shërbimi për punë të përgjithshme dhe të përbashkëta i qeverisë t'i mbulojë shpenzimet e udhëtimit dhe qëndrimit jashtë vendit për anëtarët e familjeve të pacientëve maqedonas që trajtohen jashtë vendit.

Djegiet dhe operacionet

Ministria bullgare e Shëndetësisë ka thënë se gjendja e 14 pacientëve të lënduar të shtruar në disa spitalet në Bullgari është e rëndë për shkak të djegieve dhe thithjes së gazrave të nxehtë. Në spitalin "N. I. Pirogov" në Sofje janë pranuar tetë pacientë, tre prej të cilëve janë të mitur të moshës 15 dhe 16 vjeçe. Pesë të tjerët janë nga moshë 19 deri 31

vjeçe. Tre persona të lënduar, të moshës 17, 20 dhe 15 vjeçe janë shtruar në spitalin për trajtim aktiv në Varna. Dy prej tyre janë në ventilim mekanik. Në UMBAL "Rr. Georgi" në Plovdiv, tre pacientë të moshës 19, 21 dhe 49 vjeçe janë pranuar me djegie të shkallës së dytë dhe të tretë, si dhe dëmtime nga thithja e gazrave të nxehtë. Në Qendrën Emergjente në Beograd të dielën janë pranuar nëntë persona të lënduar, njëri prej të cilëve ka lëndime jashtëzakonisht të rënda, të rrezikshme për jetën, njoftoi Ministria e Punëve të Brendshme e Serbisë. "Të lënduarit që u dërguan në Qendrën Emergjente kanë djegie që variojnë nga dy deri në 28 për qind të sipërfaqes së trupit dhe ky është një vlerësim fillestar që nga mbrëmë. Disa nga të lënduarit kanë djegie në traktin e sipërm respirator", ka thënë Millan Stojić, drejtor i Klinikës për Djegie, Kirurgji Plastike dhe Rikonstruktive në Qendrën Klinike Universitare të Serbisë. Sipas tij, të gjitha lëndimet mjekët në Klinikë i trajtojnë si lëndime të rënda, të rrezikshme për jetën. Ekipet mjekësore nga Serbia, Republika Çeke, Izraeli dhe Belgjika kanë mbërritur në Maqedoninë e Veriut. Ata do të vendosen në klinika ku ka nevojë.

Eurodeputeti francez, ShBA-së: Na ktheni 'Statujën e Lirisë'

PARIS, 17 MARS - "Na ktheni Statujën e Lirisë", është kërkesa e çuditshme e bërë nga socialisti francez Raphaël Glucksmann, sipas të cilit, Parisi duhet ta marrë mbrapsht monumentin sepse Shtetet e Bashkuara nuk përfaqësojnë më vlerat që e shtynë Francën të bëjë këtë dhuratë. "Amerikanëve që kanë zgjedhur të qëndrojnë në anën e tiranëve, të cilët pushojnë studiuesit sepse kërkojnë liri shkencore, ne u themi: na ktheni statujën. Ne ua dhamë, por ju duket se e përbuzni. Kështu që do

të jetë mirë këtu në shtëpi", ka thënë eurodeputeti dhe themeluesi i "Place Publique", në një konventë. Statuja e Lirisë është zbuluar në portin e qytetit të Nju-Jorkut më 28 tetor 1886, në 100-vjetorin e Deklaratës Amerikane të Pavarësisë si një dhuratë nga populli i Francës për Amerikën. Është projektuar nga francezi Auguste Bartholdi. Parisi ka një kopje shumë më të vogël të statujës në një ishull të vogël në Paris. Glucksmann, një mbrojtës i vendosur i Ukrainës, ka kritikuar ashpër ndryshimin

rrënjësor të presidentit Donald Trump në politikën e ShBA-së për luftën. Ai, gjithashtu, ka synuar shkurtime të Trump në institucionet kërkimore të ShBA-së, të cilat tashmë kanë nxitur qeverinë franceze të nisë një iniciativë për të tërhequr disa prej tyre për të punuar në Francë. "Gjëja e dytë që do t'u themi amerikanëve është se nëse doni të pushoni studiuesit tuaj më të mirë, nëse doni të pushoni të gjithë njerëzit që, përmes lirisë së tyre dhe ndjenjës së tyre të



inovacionit, shijes së tyre për dyshim dhe kërkime, e kanë bërë vendin tuaj fuqinë

kryesore botërore, atëherë ne do t'i mirëpresim ata", ka thënë ai.

SORENSEN: KOMPROMISET NË DIALOG I PËRCAKTOJNË PALËT



PRISHTINË, 17 MARS - I dërguari i Bashkimit Evropian për dialogun Kosovë - Serbi, Peter Sorensen, është takuar të hënën në Prishtinë me presidenten Vjosa Osmani dhe kryeministrin Albin Kurti. Sorensen ka thënë se prioritet për të do të jetë të sigurojë takime mes përfaqësuesve të Kosovës dhe Serbisë. Sipas tij, janë vetë palët që pastaj do të vendosin për kompromise potenciale. “Dialogu është për t’u siguruar që të ketë takime. Se a do të thotë kjo kompromise apo jo, u takon palëve për ta përcaktuar”, ka thënë Sorenseni në një prononcim për medie pas takimit me kryeministrin e Kosovës, Albin Kurtin. Takimi i fundit në Bruksel i ndërmjetësuar nga Bashkimi Evropian, në mes të Kosovës dhe Serbisë, ishte zhvilluar më 17 dhjetor të vitit të kaluar. Sorenseni po e viziton Kosovën për herë të parë prej se e mori detyrën në fillim të shkurtit, për t’u takuar me zyrtarë të lartë të vendit. Ai e quajti takimin me Kurtin “fillim të mirë”. “Ishte një takim prezantues, folëm për atë se si mund të vazhdojë procesi përpara. Është një fillim i mirë. Sapo t’i kem bërë këto biseda [me përfaqësuesit e Kosovës dhe Serbisë], mund të ulem dhe të vlerësoj se ku jemi. Por, është shumë e qartë që procesi i dialogut mban në vete edhe një numër të madh të zhvillimeve të rëndësishme dhe duhet të merremi edhe me to”, ka thënë Sorenseni. Më herët, Sorenseni ka zhvilluar takim edhe me presidenten e Kosovës, Vjosa Osmani. Pas takimit, Osmani

ka thënë se ka kërkuar nga Bashkimi Evropian (BE) ta trajtojë Kosovën në mënyrë “të barabartë” në dialogun e Brukselit. Në “Facebook”, Osmani ka thënë pas takimit se Kosova “është dëshmuar tashmë si pala konstruktive në dialog, e angazhuar për paqe, demokraci e sundim të ligjit”. “Prandaj mbajtja e masave të padrejta të BE-së ndaj vendit tonë po i dëmton jo vetëm qytetarët tanë, por edhe balancën e nevojshme në dialog”, ka thënë Osmani. Blloku evropian ka vendosur masa ndëshkuese ndaj Kosovës më 2023, pas rritjes së tensioneve në veri të vendit. BE-ja pati vlerësuar se Qeveria e Kosovës nuk ka bërë mjaftueshëm për shtensionim. Sorenseni ende nuk e ka ndërmjetësuar ndonjë takim të dialogut në mes të Kosovës dhe Serbisë në Bruksel, por ka punuar kohën e fundit për mënyrat për ta çuar përpara dialogun, duke takuar ndaras zyrtarë nga të dyja vendet. Ai e ka marrë detyrën më 1 shkurt, duke e pasuar Miroslav Lajçakun. Në takimin e fundit në Bruksel nën ndërmjetësimin e Lajçakut, më 17 dhjetor, Kosova dhe Serbia u pajtuan për zbatimin e plotë të deklaratës së përbashkët për personat e zhdukur. Shefja e diplomacisë së Bashkimit Evropian (BE), Kaja Kallas, ka thënë muajin e kaluar se po dëgjonte kritika rreth formatit të deritashëm të dialogut në mes të Kosovës dhe Serbisë. Ajo ka paralajmëruar se, së bashku me Sorensenin, po shqyrtonte mundësinë për

ta bërë funksional dialogun mes dy vendeve fqinje. Kosova dhe Serbia dialogojnë nën ndërmjetësimin e Bashkimit Evropian që nga viti 2011. Në vitet e fundit dialogu është zhvilluar në nivel të lartë, mes liderëve të dy vendeve, dhe në nivel kryenegociatorësh. Gjatë mandatit gati pesëvjeçar të të dërguarit të kaluar të bllokut, Miroslav Lajçakut, në fillim të vitit 2023 Kosova dhe Serbia arritën Marrëveshjen për në rrugën drejt normalizimit të marrëdhënieve. Marrëveshja, e cila nuk është nënshkruar, është ligjërish e detyrueshme për palët, ka thënë blloku, i cili i ka akuzuar Kosovën dhe Serbinë për mosnjsien e zbatimit të paktit. Në të kaluarën, liderët e Kosovës, nisur nga presidentja e vendit, Vjosa Osmani e deri te kryeministri Albin Kurti, e kanë kritikuar Lajçakun për qasje të pabalancuar në dialog dhe për rreshtim me raste kah Serbia. Nuk është e qartë se kur mund ta mbajë takimin e parë Sorenseni në kuadër të dialogut, duke qenë se Kosova ka mbajtur zgjedhje më 9 shkurt dhe pritet ta formojë qeverinë e re, ndërsa Serbia përballet me paqartësi politike midis protestash të mëdha të studentëve. Kallasi ka thënë në shkurt se po priste derisa Kosova të formojë qeveri të re, për të “parë se si të vazhdojmë tutje”. Sorenseni, për dallim nga paraardhësi i tij, do të merret vetëm me dialogun ndërmjet dy vendeve fqinje, e jo edhe me çështje rajonale të Ballkanit.

Emërimi i Sorensenit është parë si pozitiv, duke qenë se 57-vjeçari e njëh rajonin. Diplomati prej shumë vitesh, ai ishte angazhuar në Kosovë në kuadër të Misionit të Organizatës së Kombeve të Bashkuara (UNMIK), si dhe në role të tjera, në Serbi, Maqedoni të Veriut dhe Bosnjë-Hercegovinë. Sipas njohësve të politikës, ai nuk ka nevojë të informohet paraprakisht për njerëzit apo faktet historike të rajonit, sepse tashmë ka pasur mundësinë ta krijojë një pasqyrë nga afër. Një tjetër argument që është përmendur si pozitiv nga zyrtarët në Prishtinë është se ai është nga Danimarka, vend që një shtetësinë e Kosovës, dhe se do të ketë qasje të barabartë në dialog.

Kurti kërkon nga emisari i BE-së heqjen e masave ndaj Kosovës

Kryeministri i Republikës së Kosovës, Albin Kurti, ka pritur të hënën në takim emisarin e Bashkimit Evropian (BE) për dialogun Kosovë - Serbi, Peter Sorensen. Në këtë takim të parë zyrtar në zyrën e kryeministrit, Kurti e ka uruar Sorensenin për rolin e ri dhe e ka njoftuar me zhvillimet e fundit në vend dhe për hapat drejt formimit të institucioneve në legjislaturën e 9-të. “Kryeministri kërkoi nga emisari Sorensen që BE-ja të heqë menjëherë masat e

padrejta kufizuese ndaj Kosovës. Ai theksoi kontradiktën e pashëndetshme për BE-në, vlerat themelore të saj dhe për reformat e ndërmarra nga Qeveria e Kosovës me mbështetje të madhe të qytetarëve, që në të njëjtën periudhë kur vendi shënon ngritjen më të madhe demokratike, edhe sipas indekseve ndërkombëtare, të jetë njëkohësisht nën masa kufizuese të BE-së”, ka njoftuar zyra e kryeministrit. Sipas këtij njoftimi, ata kanë biseduar edhe për procesin e dialogut dhe zbatimin e marrëveshjeve të arritura në Bruksel dhe Ohër. “Diskutuan për procesin e dialogut të ndërmjetësuar nga BE dhe për rrugën përpara. Kryeministri theksoi rëndësinë e zbatimit të plotë dhe të pakushtëzuar të marrëveshjes Bazike dhe Aneksit të Ohrit. Duke rikujtuar sulmin paramilitar në Banjskë në shtator të vitit 2023 dhe sulmin terrorist në Ibër-Lepenc në nëntor të vitit të kaluar, ai gjithashtu nënvizoi rrezikun që kryeterroristi Millan Radoiqiq, bashkë me grupin e tij, vazhdon të paraqes për sigurinë e vendit dhe normalizimin e marrëdhënieve në kuadër të procesit të dialogut për sa kohë që vazhdon të jetë i lirë në Serbi, përkundër pranimit të fajësisë para autoriteteve në Serbi dhe aktakuzës 160 faqëshe nga Prokuroria e Republikës së Kosovës. Andaj, përsëriti thirrjen, që Radoiqiq dhe grupi i tij t’i dorëzohet Kosovës për gjykim”, ka njoftuar zyra e kryeministrit.

Vetëvendosje kundër rezultateve përfundimtare të zgjedhjeve, ankohet në PZAP

Prishtinë, 17 mars - Anulim të 18 mijë votave me postë të LDK-së, shpallje të rivotimit me postë në diasporë, eliminim nga lista të Hysen Çekajt, ishin këto tri ankesat që Lëvizja Vetëvendosja i ka çuar në Panelin Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrës (PZAP) në orën e fundit të afatit të ligjshëm për ankesa, pas shpalljes së rezultateve

përfundimtare zgjedhore e që do të duhej të hapte rrugë për certifikimin final. Blerim Sallahu dhe Alim Rama nga kjo parti kanë njoftuar se kanë dërguar “20 faqe” ankesë me pretendimet se kanë “prova të manipulimeve” të votave nga LDK-ja. “Dorëzuam ankesë kundër vendimit të KQZ-së për shpalljen e rezultateve

përfundimtare me pretendimet tona lidhur me votimet me postë për shkak të manipulimeve keqpërdorimeve të shumta të anëtarëve të LDK-së, lidhur me votimet me postë, që këto votime kanë pasur një adresë të vetme, dhe kështu votimi ka ndodhur në formë të manipuluar masivisht dhe me kimik e duar të njëjta”, ka

thënë Sallahu, duke kërkuar që të eliminohet kjo padrejtësi. “LV-ja kërkoi nga PZAP që të eliminojë këtë padrejtësi të madhe që ka ndodhur. Vendimi duhet patjetër duhet të jetë rivotim, dhe rishprehje e vullnetit të qytetarëve. Të anulohen 18 mijë vota të LDK-së. Të ketë rivotim të serishëm të votimit me postë”, ka thënë ai.





SOT I JEPET LAMTUMIRA E FUNDIT BABAIT TË HASHIM THAÇIT

Sot (e martë) do t'i jepet lamtumira e fundit babait të ish-presidentit Hashim Thaçi, Haxhi Thaçi, i cili ka ndërruar jetë të dielën në moshën 87-vjeçare. Para ceremonisë së varrimit, e cila është planifikuar të mbahet në orën 15:00 në fshatin Burojë, në palestrën "Ilaz Kodra" në Skenderaj do të bëhen homazhe pranë arkivolit të tij dhe do të mbahet një mbledhje përkujtimore kushtuar bacës Haxhi. Familja e Thaçit do të mbajë tri ditë të pame në palestrën "Ilaz Kodra" në Skenderaj, ndonëse nga hëna janë hapur dyert për ngushëllime, ku në Burojë kanë shkuar liderë të institucioneve, të partive dhe qytetarë të shumtë



përrjetshëm dhe i lehtë i qoftë dheu i Kosovës.

Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, përmes një letër ngushëllimi, në emër të qeverisë dhe të tij, ka ngushëlluar familjen Thaçi për humbjen e më të dashurit të tyre, Haxhi Thaçit. Për të ndjerin, kryeministri u shpreh se do të kujtohet gjithmonë për urtësinë e tij, respektin për të tjerët dhe dashurinë e madhe për vendin. "Në emër të Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe timin ju shpreh ngushëllimet më të sinqerta juve, dashamirëve të familjes suaj dhe miqve të ish-presidentit Hashim Thaçi", është thënë në letër ngushëllimin e Kurtit.

EPOKA E RE

Lirim GECI

PRISHTINË, 17 MARS - Komuna e Skenderajt e ka marrë përsipër organizimin e ceremonisë së varrimit të babait të ish-presidentit Hashim Thaçi, Haxhi Thaçi, i cili ka ndërruar jetë të dielën në moshën 87-vjeçare.

Ceremonia e varrimit do të mbahet sot (e martë) në fshatin Burojë të Skenderajt. Para ceremonisë së varrimit, në palestrën "Ilaz Kodra" në Skenderaj do të bëhen homazhe pranë arkivolit të Haxhi Thaçit dhe do të mbahet një mbledhje përkujtimore kushtuar bacës Haxhi. Familja e Thaçit do të organizojë të pame për tri ditë me radhë, e cila do të mbahet në palestrën "Ilaz Kodra" në Skenderaj. Ndonëse ditët për ngushëllime janë përcaktuar të jenë 19-21 marsi, të hënën qytetarë të shumtë dhe liderë të partive politike kanë shkuar për ngushëllime në familjen Thaçi në Burojë të Skenderajt. Kujtojmë se baca Haxhi ka ndërruar jetë vetëm pak ditë pas vizitës që ia ka bërë në QKUK djali i tij, Hashim Thaçi, i cili që nga nëntori i vitit 2020

është duke u mbajtur në paraburgim në Hagë. Thaçi kishte bërë disa herë kërkesë ta vizitojë babanë tashmë të ndjerë, por nuk ishte lejuar nga Gjykata Speciale.

Osmani dhe Kurti ngushëllojnë Thaçin për humbjen e babait

Presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani, ka shprehur ngushëllime për ndarjen nga jeta të Haxhi Thaçit, babait të ish-presidentit dhe ish-kryeministrit të Republikës së Kosovës, z. Hashim Thaçi.

Në një mesazh ngushëllimi, Osmani e ka cilësuar humbjen e një prindi si një dhimbje të pamatshme, që lë një boshllëk të pazëvendësueshëm te të dashurit. "Me pikëllim mësuam lajmin për ndarjen nga jeta të z. Haxhi Thaçi, babait të ish-presidentit dhe ish-kryeministrit të Republikës së Kosovës, z. Hashim Thaçi.

Humbja e babait është dhimbje e pamatshme, e cila lë boshllëk të pazëvendësueshëm tek më të dashurit", ka theksuar Osmani. Ajo ka shtuar se kontributi dhe dashuria e Haxhi Thaçit për atdheun do të mbeten udhërrëfyes dhe kujtime krenarie për të gjithë ata që e njohën.

Presidentja Osmani ka shprehur ngushëllimet më të sinqerta në emër të saj dhe të popullit të Kosovës për ish-presidentin Thaçi, familjen e tij dhe të gjithë miqtë dhe të afërmit e Haxhi Thaçit. "Kontributi dhe dashuria e tij për atdheun, shpresoj të shndërrohen në udhërrëfyes dhe kujtime krenarie për të gjithë ata që e njohën. Në emrin tim dhe në emër të popullit të Kosovës, ju shpreh ngushëllimet më të sinqerta ish-presidentit Thaçi, gjithë familjes Thaçi, si dhe miqve e të gjithë të afërmit të z. Haxhi Thaçi", ka thënë Osmani. Në fund ajo ka nënvizuar se kujtimi për të do të jetë i

Krasniqi me zyrtarë të lartë të PDK-së shkojnë në Burojë për ngushëllime: Dhimbja rritet për shkak të mungesës së Thaçit

Kryetari i Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), Memli Krasniqi, bashkë me zyrtarë të lartë të partisë, kanë shkuar për ngushëllime në Burojë me rastin e vdekjes së babait të ish-presidentit Thaçi, Haxhi Thaçi.

Krasniqi ka thënë se me këtë humbje dhimbja bëhet më e madhe duke ditur se Hashim Thaçi nuk gjendet në Kosovë. Krasniqi e ka kujtuar Haxhi Thaçin si njeri të buzëqeshur e si karakter epik. "Ka qenë njeri që vërtetë i them më shumë se prind, baba i njeriut që e ka udhëhequr procesin e çlirimit dhe pavarësisë së vendit. Karakter epik. Shqiptarët e mirë, të vërtetë, që kanë ditur t'i edukojnë gjithë brezat. I buzëqeshur gjithmonë, njeri që na ka përkrahur gjithmonë, dhe fjalët e tij, këshillat e tij, kujtimet me të do t'i mbajmë gjithmonë si të veçanta.



RRUGË E MBARË PËR NË PARAJSË, HAXHI THAÇI!



Behxhet Sh. SHALA -
BAJGORA

Vdekja e lirë në Kosovën e robëruar nga injorantët: Haxhi Thaçi, babai i ish - presidentit të Kosovës, Hashim Thaçi që, bashkë me çlirimtarë tjerë po mbahen peng në burgun e Hagës, ndërroi jetë përkatësisht iku nga një gjendje materiale në një gjendje shpirtërore duke e fituar përjetësinë sikur të gjithë prindërit e patriotëve tjerë shqiptarë.

Së paku, nuk iku me mallin e birit Hashim Thaçi që e krijoi dhe e vulosi historinë e shqiptarëve në luftën për çlirim, liri, pavarësi dhe shtet, drejt një

qëllimi të fundit, bashkimit e të gjithë shqiptarëve në një shtet, në të madhërishten Shqipëri për të cilën pati aq shumë viktima dhe gjakime të patriotëve të vërtetë shqiptarë. Thonë se njeriu e parandien kohën kur fillon rrugëtimi i shpirtit të tij drejt një adrese të panjohur por se procesi nuk fillon pa takimin me atë që e ka peng edhe Haxhi Thaçi si baba sikur edhe Hashim Thaçi si biri i tij.

Prandaj Krijuesi i të gjitha botëve e caktoi pikëtakimin midis babait dhe të birit për të hequr pengun që Haxhi Thaçi të nisë rrugëtimin drejt amshimit kurse Hashim Thaçi për të fundin herë të marrë bekimin nga një baba që e edukoi dhe rriti që të bëhet shërbëtor besnik i njerëzimit dhe Kombit që i takon, si pjesë e pandashme e këtij njerëzimi.

Thonë, edhe nga këndi fetar por edhe praktik se shpirti nuk del pa e përmbushur pengun. Kur

më pati vdekur babai im, Shaban Shala apo Shaban Bajgora, si e njihnin, në pamundësi të më takojë (isha i izoluar në burgun e Gospiqit, Kroaci), para se të ndërronte jetë, mua më ka gjetur te një shok i mrekullueshëm i Burgut, Abdullah Rama që ka qëndruar afër Babait, sikur të isha unë. Në Avdullahun më ka parë mua dhe pasi ia ka shtrirë dorën dhe dëgjuar zërin, ndonëse në gjendje gjysmë kome ka thënë: “erdhë Dulla” dhe pas 5-10 minuta, i lehtësuar ka ndërruar jetë. Shumë të burgosurve politikë shqiptarë në ish-Jugosllavi iu kanë vdekur prindërit pa i parë as për herë të fundit, të gjallë apo të vdekur, pa marrë pjesë në ceremoni mortore e as për kryeshëndosh. Madje, as në varrime nuk kanë guxuar të marrin pjesë përveç familjeve që e kishin fatin tonë. Kohë të vështira që nga pak na ligështonin por asnjëherë nuk na thyenin!

Një shekull jetë, për një përjetësi: Haxhi Thaçi jetoi thua 87 vjet, moshë e lakmuar për çdo njeri. Shëndetin e kishte të rrënuar, malli për të birin e kishte oksigjen të jetës. Edhe për çlirimtarët tjerë që e ndajnë të njëjtin fat me të birin, ish-presidentin Hashim Thaçi. Si prind dhe baba i përmbushi të gjitha detyrimet ndaj Zotit, kombit dhe atdheut. E edukoi të birin dhe fëmijët sipas parimeve hyjnore, kombit i dha një udhëheqës të pashoq i shoqëruar me bashkëfamiljarë që e përcillnin në çdo sfidë dhe betejë, deri në çlirim kurse Atdheut i dha një burrështetas që e bëri luftën, shpalli pavarësinë dhe e bëri shtetin. Çka duhet të bëjë tjetër një vdekatar i rëndomtë përveç se e bëri Haxhi Thaçi përmes Hashim Thaçit sikur që të njëjtën e bënë prindërit tanë, përmes neve, shokë të idealit, veprimit dhe luftës me Hashim Thaçin!

Haxhi Thaçi i kreu të gjitha detyrimet që i pati si njeri, shqiptar dhe baba prandaj e ka tërë këtë respekt nga patriotët e vërtetë dhe njerëzit e mirë prandaj nuk ka nevojë të qahet e as të ngushëllohet. Qahen, vajtojnë dhe kujisin vetëm të ligët ndërsa ngushëllimin e kërkojnë ata që nuk kanë bërë asgjë në dhe për jetën e tyre, për të tjerët hiç se hiç! Në botë të këqijtë janë shumicë, në Kosovë janë shumicë absolute, më shumë pushtet! Prandaj kanë mungesë respekti për sakrifikuesit, madje shumë i urrejnë!

Përkundër kësaj, në rrugën tonë të madhe kemi tejkaluar pengesa shumë më të mëdha, pa urrejtje dhe hakmarrje. Falë prindërve tanë, falë njerëzve si Haxhi Thaçi. Rrugë e mbarë për në parajsë Haxhi Thaçi, kush e ka merituar më shumë se ti që i përmbushë të gjitha detyrimet ndaj Zotit, kombit, atdheut dhe njerëzimit?!

Vdekja bëhet edhe më e rëndë për shkak të mungesës së Thaçit, së paku pati mundësi ta takojë atë. Vërtet kjo dhembje rritet për familjen, për ne, për shkak të mungesës së presidentit Thaçi”, ka thënë Krasniqi.

Haradinaj ngushëllon Thaçin dhe viziton familjen e tij në Burojë

Edhe lideri i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), Ramush Haradinaj, i ka shprehur ngushëllime familjes për vdekjen e babait të ish-presidentit të vendit, Hashim Thaçit, Haxhi Thaçi. Haradinaj ka shkruar në “Facebook” se baba Haxhi e mbylli jetën duke lënë pas një histori të tërë sfidash e sakrificash. Ai ka thënë se në këtë ditë zie familja Thaçi po përballlet jo vetëm me humbjen e njeriut të dashur, por edhe me mungesën e Hashimit, i cili, me bashkëluftëtarët e tjerë, po mbron luftën e shenjtë të UÇK-së në Hagë. “Lajm i hidhur ndarja nga jeta e Haxhi Thaçit, babait të luftëtarit të orëve të para, bashkëluftëtarit tim dhe ish-Presidentit të Kosovës, Hashim Thaçi. Baca Haxhi e mbylli jetën duke lënë pas një histori të tërë sfidash e sakrificash, por ndarja e tij vjen në një moment edhe më të rëndë për familjen Thaçi. Në këtë ditë zie, familja Thaçi po përballlet jo vetëm me humbjen e njeriut të tyre të dashur, por edhe me mungesën e Hashimit, i cili, me bashkëluftëtarët e tjerë, po mbron luftën e shenjtë të UÇK-së në Hagë. Në këtë moment dhimbjeje, jam

pranë mikut dhe bashkëluftëtarit tim Hashimit dhe mbarë familjes Thaçi. Zoti ju forcoftë!”, ka shkruar Haradinaj.

Po ashtu, Haradinaj ka shkruar për ngushëllime në Burojë të Skenderajt. Haradinaj në të pame u ka shprehur ngushëllime familjarëve të Haxhi Thaçit.

Ali Ahmeti ngushëllon Thaçin: Haxhi Thaçi ishte një baba që i dha Kosovës një çlirimtar

Kryetari i Bashkimit Demokratik për Integrim (BDI), Ali Ahmeti, ka thënë se me dhimbje të thellë ka marrë lajmin për ndarjen nga jeta të Haxhi Thaçit, babait të ish-presidentit Hashim Thaçi. “Fatmirësisht para pak ditësh e pritja për ta takuar për herë të fundit heroin e Kosovës, të birin e tij që padrejtësisht po mbahet në burg. Haxhi Thaçi ishte një baba që i dha Kosovës një çlirimtar, një burrë që me përkushtimin dhe edukatën e tij ndihmoi në lindjen e një epoqe të re për kombin tonë. Ngushëllime miku im Hashim Thaçi dhe gjithë familjes Thaçi!”, ka shkruar Ahmeti në “Facebook”.

Për vdekjen e babait, Hashim Thaçi është ngushëlluar edhe nga ish-presidenti Fatmir Sejdiu, ish-kryeministri Isa Mustafa, organizatat e dala nga lufta e UÇK-së, kryetari i Prishtinës, Përparim Rama, kryetari i PSD-së, Dardan Molliqaj, ai i Lëvizjes për Bashkim, Valon Murati, deputetë të Kuvendit të Kosovës, ministra etj.

Veseli, Selimi dhe Krasniqi ngushëllojnë nga Holanda për vdekjen e Haxhi Thaçit



Liderët e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, Kadri Veseli, Jakup Krasniqi dhe Rexhep Selimi, nëpërmjet një telegrami ngushëllimi kanë shprehur ngushëllimet e tyre për vdekjen e Haxhi Thaçit, babait të Hashim Thaçit.

Në telegramin e ngushëllimit, të publikuar nga Fondacioni “Përkrahje për Mbrojtjen Juridike të Hashim Thaçit”, ish-krerët e UÇK-së thonë se Haxhi Thaçi ishte bashkëpjesëmarrës në të gjitha proceset e lëvizjes kombëtare të shekullit të kaluar. “E nderuara familja Thaçi, Me dhimbje morëm lajmin e ndarjes nga jeta të bashkëshortit dhe prindit tuaj të dashur, si dhe bashkudhëtarit tonë në rrugën e lirisë, i cili nuk kurseu asgjë për jetën dhe lirinë. Haxhi Thaçi, më shumë sesa vetëm prind i një prej themeluesve të UÇK-së dhe Shtetit të Kosovës, ishte edhe vetë bashkëpjesëmarrës i drejtpërdrejtë në të gjitha proceset e lëvizjes sonë

kombëtare të shekullit të kaluar. Ndarja e tij nga kjo jetë është jo vetëm dhimbje, por edhe kujtim dhe mesazh se njerëzit jetojnë dhe nuk shuhen nga kjo botë nëse i kanë shërbyer më shumë sesa vetvetes – nëse i kanë shërbyer së mirë, vendit, nderit dhe

kombit të tyre. Familjarëve të nderuar, të gjithë miqve dhe dashamirësve të Bacës Haxhi dhe familjes Thaçi, ju shprehim ngushëllimet tona më të sinqerta njerëzore, si dhe krenarinë për të. I lehtë i qoftë dheu i Kosovës!”, është thënë në telegramin e ngushëllimit.

Agjenda e ceremonisë mortore:

Ceremonia e varrimit do të mbahet nën përkujdesjen e kryetarit të Komunitetit të Skenderajt, z. Fadil Nura. Këto janë aktivitetet që do të organizohen nga Komuna e Skenderajt:
Homazh pranë arkivolit:
Data: 18 mars 2025
Ora: 09:00 – 12:00
Vendi: Palestra “Ilaz Kodra”, Skenderaj.
Mbledhja komemorative:
Data: 18 mars 2025
Ora: 12:00
Vendi: Palestra “Ilaz Kodra”, Skenderaj.
Varrimi i të ndjerit:
Data: 18 mars 2025
Ora: 15:00
Vendi: Varrezat e reja të fshatit Burojë, Skenderaj.
E pamja e familjes Thaçi:
Data: 19 - 21 mars 2025
Vendi: Palestra “Ilaz Kodra”, Skenderaj.



INTERVISTË ME MUHAMET MAVRAJN NË "EDICIONI SPECIAL" NË "TV KLANKOSOVA" MË 14 MARS 2025 ME GAZETARIN SHKODRAN GAJRAKU, NJË DITË PAS VIZITËS SË PRESIDENTIT THAÇI QË I BËRI BABAIT TË SËMURË NË SPITAL (PRISHTINË) DHE TRE DITË PARA VDEKJES SË BABAIT TË TIJ

THAÇI, SHQIPTAR I MADH, DINJITOZ DHE KRIJUESI KRYESOR I HISTORISË SË RE TË KOSOVËS

Askush nuk është krenar që të vijë pas 55 muajsh ta vizitojë babanë e vet në spital dhe në gjendje jo të mirë shëndetësore. Më shumë sesa krenar, Hashimi u tregua di-nji-toz. Dinjitoz! Dhe për mua nuk ka kurrjë më të naltë në vlerat dhe qëllimet e njeriut sesa të jetë dinjitoz. Pavarësisht situatës në të cilën ai ishte, me paraqitjen e tij, me përshëndetjen e tij, me qëndrimin e tij, me stabilitetin e tij, ai tregoi çka ka humbur Kosova faktikisht, përkohësisht, tash për tash, - një lider të madh, pra përkohësisht, por edhe çfarë e pret Kosovën në të ardhmen kur ai të kthehet herët a vonë këtu dhe herët a vonë plotësisht i pafajshëm, jo vetëm ai, por i tërë Shtabi i Përgjithshëm i UÇK-së që po mbahet atje dhe pjesëtarët e UÇK-së që po mbahen bashkë me ta në Hagë.

KlanKosova: Për vizitën e djeshme të Hashim Thaçit në Kosovë, për procesin gjyqësor dhe të tjera që lidhen rreth këtij procesi gjyqësor do të flasim tani këtu në studio me Muhamet Mavrajn, një shok i vjetër, i kahershëm i Hashim Thaçit, njëkohësisht bashkë-themelues i PDK-së, por edhe njeri nga drejtuesit e protestës së madhe studentore, pra të viteve të '90-a.
Profesor Mavraj, mirëserdhët në

KlanKosova!

Mavraj: Mirë se ju gjeta! Faleminderit shumë për ftesën!

KlanKosova: Qysh u ndiet dje kur e patë Hashim Thaçin në atë gjendje, i rrethuar nga njerëz me maska kur po shkonte për ta vizituar babanë e tij të sëmurë?

Mavraj: Vizita, tash nëse e shohim kështu në perceptim ka disa aspekte. Puna e parë është aspekti humanitar, çështja

njerëzore. Ai erdhi për vizitë tek babai i tij, jo në shtëpi, por në spital ku po trajtohet për një kohë bukur të gjatë për shkak të pleqërisë së tij dhe të atyre vështirësive shëndetësore që po e përcjellin. Aspekti i dytë është edhe kjo ana vizuale për të cilën është diskutuar shumë, por që nuk është ajo që më ka prekur aq shumë sa është thjesht ajo ndjenja ose empatia, ndjesia, fuqia e ndjeshmërisë për një shqiptar të madh që nga grillat

lejohej me mezi që ta vizitojë babanë në spital...

KlanKosova: ... Një shqiptar i madh...

Mavraj: Po! Një shqiptar i madh për shkak se, siç e kam thënë njëherë dhe nuk jam zgjeruar më shumë, Hashim Thaçi është ndër ata pak historianë që në të vërtetë nuk e ka shkruar, por e ka krijuar historinë e re të Kosovës, dhe për ata pak historianë, dhe nga këta pak historianë ai është kryesori. Kështu e kam thënë dhe asgjë më shumë nuk shtoj dhe nuk heq për sa i përket definicionit tim për të. Përtej elozheve, përtej lavdeve për të cilat ai fare nuk ka nevojë, ne duhet ta shohim ngapak edhe aspektin politik. Aspektin politik që ka të bëjë me Kosovën dhe jo personalisht më të.

KlanKosova: Me të...

Mavraj: Tani situata ku ndodhet Kosova, pesë vite pas burgosjes së tij është e qartë për të gjithë, për ata që jetojnë këtu, për ata

që e kanë lëshuar Kosovën, për ata që janë të burgosur atje e kështu më radhë. Mendoj se ky shqiptar i madh, me vetë ardhjen e tij këtu bëri një bumë të jashtëzakonshëm shpirtëror në mbarë Kosovën...

KlanKosova: ... U komentua në forma të ndryshme. Dikush tha se edhe dielli nxente më mirë dje...

Mavraj: Po, kur e sheh aspektin emocional padyshim që njerzit e ndjejnë ashtu, dhe e vërteta e madhe nuk janë disa postime negative që bëhen me porosi kundër tij për të treguar një çnjerëzillak të shfrenuar që herë pas here e shohim këtu në Kosovë. Por, ajo që në të vërtetë njerëzit e kanë ndjerë, përfshirë kundërshtarët e tij, -keqardhja, patjetër, - për shkak të situatës së tij, gjendjes së babait, vështirësive, padrejtësive të shumëfishta, të zgjatura, të stërzgatura të Gjykatës Speciale vetëm për këtë rast familjar, pra veç sa i përket aspektit familjar, e mos të flasim pastaj për

stërzgatjen e qëllimshme atje në Hagë që, ndoshta-ndoshta deri më tash i ka prekur kufijtë e krimi kundër njerëzimit, sepse këta i kanë marrë me pretendimin për ndonjë shuplakë që ndonjë ushtar mund të ia ketë dhënë ndokujt ose për ndonjë ndalim dy-tre orësh ose dy-tre ditësh, ndërsa me viite, me viite, liderët historikë të Kosovës po i mbajnë atje pa bazë ligjore të qartë dhe duke e shkelur besimin e Kosovës që ia ka dhënë asaj gjykatë. Kur them duke e shkelur besimin, mjafton të bazohem vetëm në këto stërzgatje, mjafton. Këta janë burgosur, siç dihet, pa aktakuzë. Aktakuza është ngritur shumë më vonë. Ligjet thonë diçka tjetër. Premtimet kanë qenë për mbajtje njëvjeçare në paraburgim dhe në ndërkohë ne po shkojmë drejt vitit të pestë, Shkodran.

KlanKosova: Nëse flasim për fotografinë e ish-presidentit Thaçi të bërë në ato shkallët, në QKUK... U komentua në forma të ndryshme. U tha që z. Thaçi shihej se ishte krenar, ndonëse i vuajtur. Për juve që e keni mik të hershëm që nga paralufta, në luftë, pas luftës e deri më tani e po ashtu e keni vizituar edhe në Hagë...

Mavraj: Askush nuk është krenar që të vijë pas 55 muajsh ta vizitojë babanë e vet në spital dhe në gjendje jo të mirë shëndetësore. Më shumë sesa krenar, Hashimi u tregua di-nji-toz. Dinjitoz! Dhe për mua nuk ka kurrëgjë më të naltë në vlerat dhe qëllimet e njeriut sesa të jetë dinjitoz. Pavarësisht situatës në të cilën

ai ishte, me paraqitjen e tij, me përshëndetjen e tij, me qëndrimin e tij, me stabilitetin e tij, ai tregoi çka ka humbur Kosova faktikisht, përkohësisht, tash për tash,- një lider të madh, pra përkohësisht, por edhe çfarë e pret Kosovën në të ardhmen kur ai të kthehet herët a vonë këtu dhe herët a vonë plotësisht i pafajshëm, jo vetëm ai, por i tërë Shtabi i Përgjithshëm i UÇK-së që po mbahet atje dhe pjesëtarët e UÇK-së që po mbahen bashkë me ta në Hagë.

KlanKosova: A prisni që kjo të ndodhë së shpejti?

Mavraj: Është vështirë të prognozohet me këtë organizatë gjyqësore dhe me këto prapavija të thella, të errëta, që i ka kjo gjykatë. Por, siç e thashë, herët a vonë ai do të vijë dhe herët a vonë që të gjithë do të vijnë të pafajshëm. Mendoj se do të jetë fitore shumë e madhe, jo për ta personalisht se nuk kanë shkuar për veten e tyre që të pastrohen, por për Kosovën, sepse ata kanë shkuar që ta pastrojnë Kosovën nga ato siç është thënë tekstualisht “re të zeza mbi qiellin e Kosovës”, në atë kohë.

KlanKosova: Kemi në ekran fotografinë e tij për të cilën folëm. Dhe një krahasim që i është bërë figurës së tij, imazhit të tij (2020 dhe dje 2025)...

Mavraj: Është shpërndarë shumë. Personalisht jam shumë i prekur për shumë arsye, por njëra nga ato është se pashë ndryshim bukur të madh nga vizita që ia kam bërë këtij dhe të tjerëve në Hagë, kur ishte 25-vjetori i demonstratave të '97. Më i thinjur dhe më i lodhur, por dinjitoz, i njëjtë. Unë disa

orë kam qëndruar atje, kam biseduar bukur shumë sende me të bukur të lirshme dhe te të gjithë ata jam kujdesur që të zhbiroj, të zhbiriloj mendjet dhe shpirtin e tyre. Kanë qenë shumë të fortë, sidomos ky njeri që është shumë më i fortë sesa kanë menduar para burgut që është i tillë. Dhe, si shqiptar jam shumë, shumë, shumë krenar më të, me qëndrimin e tij, dinjitetin e tij, nëse, sidomos, nëse e marrim parasysh braktisjen too-taa-le të shtetit që ai me ushtarët e tjerë të lirisë e kanë krijuar vetë.

KlanKosova: Ku mund ta gjejë njeriu këtë forcë që po thuani që e keni parë gjatë qëndrimit tuaj në Hagë?

Mavraj: Në po atë forcë, është po ajo forcë që këta qysh të rinj i ka futur në betejën e gjatë për lirinë dhe pavarësinë e Kosovës. Janë njerëz të lindur! Dhe, askush nuk mund t'i thyejë e as poshtërojë. Këto mund të tingëllojnë si fjalë patetike, por këtë e kam thënë edhe për, bie fjala, Jakupin, që atëherë ishte 70 e sa, tash ka më shumë vite, që është i stër-vu-ajtur dhe i regjur në sfida të ndryshme. Të gjithë këta një mijë herë kanë dalë me vdekë për Kosovën. Ky burg, për këta, thjesht, është vetëm një pushim. Por, mënyra se si këta i kanë dalë zot Kosovës, duke e sakrifikuar vetveten (që të mos sakrifikohet atdheu) është storie në vetvete që, më sa e di unë, nuk e gjen askund në botë, jo në Ballkan dhe Evropë, por askund në botë.

KlanKosova: Pikërisht edhe kjo u komentua. A ishte e nevojshme gjithë ajo masë sigurie për z.Thaçin, gjithë ajo

përcjellje me njerëz të maskuar, kur i njëjti vetë ishte dorëzuar në Gjykatën Speciale?

Mavraj: Shiko, përshkrimi i sigurisë është shumë më i ashpër që u jepet trupave të sigurisë sesa ajo që ne e pamë. Ne i pamë dy-tri momente, pamë edhe përshëndetjen me mjekun e të atit të tij, hematologun Adriatik Berisha, sigurisht që pamë edhe dy-tri gjeste të atyre trupave të sigurisë, por, ne, megjithatë pamë një grimë të tolerancës, se përndryshe këta janë shumë të poshtër dhe nuk ishin aq të poshtër çfarë pamë dje. Dje nuk kanë qenë aq të poshtër sa ne i dimë.

KlanKosova: Kur s'ka kamera janë më të poshtër?

Mavraj: Ka edhe më keq, sepse këta tanët kanë shfaqur ankesa në gjykatë për mënyrën e transportimit nga qelitë deri tek dhomat ku mbahen seancat, trajtimi i tyre ka qenë më se çnjerëzor, ka qenë një kohë kur, nëse ju kujtohet reagimi i Jakup Krasniqit që e pati bërë në njërën nga ato seancat e fillimit... Por, mos ta humbim kohën shumë me këtë se është procedurë “normale”.

KlanKosova: E qartë. Thatë se është shqiptar i madh. Edi Rama e ka shpërndarë një fotografi të presidentit Thaçi dhe e ka shkruar një fjalë të vetme: Burrë...

Mavraj: Burrë po, por të shoqëruar me një shqiponjë...

KlanKosova: ...Burrë, shoqëruar me një shqiponjë...

Mavraj:... po, në kuptimin “burrë Shqipnie”.

KlanKosova: Dhe e përmendët, në anën tjetër, heshtjen dhe mosreagimin nga ana e institucioneve të Kosovës...

Mavraj: Me vjen shumë keq që kjo nomenklaturë shtetërore, ky klub politik që e udhëhoq Kosovën, këto institucione shtetërore të Kosovës, pjesa politike, ekzekutive, kanë rënë në provim moral, mos të themi edhe në provim shtetëror, disa herë. Dhe kjo është thjesht diçka që është stabilizuar, si shumë normale, sjellja jonormale e tyre ose mossjellja normale e tyre. Disa njerëz mund të komentohen për ato që i bëjnë, disa mund të komentohen për ato që nuk po i bëjnë. Ndoshta është më mirë që nuk po i bëjnë sepse edhe po t'i bënin do t'i bënin në një mënyrë që, thjesht, nuk e ndjejnë në vetvete. Por, është edhe e vërteta tjetër që s'ka kush në botë që e hedh poshtë, e matshme, emperikisht, e matshme, se pa këtë Gjykatë Speciale kjo nomenklaturë nuk do të ishte në pushtet. Prandaj, edhe është në një farë mase e kuptueshme edhe heshtja e tyre, por edhe ato betejat mbrapa skenës që i bëjnë që ata sa me gjatë të jenë në burg...

KlanKosova: Kur po thoni kjo nomenklaturë nuk do të ishte në pushtet pa Gjykatën Speciale, ka ndërlidhëshmeri apo thjesht është shfrytëzuar potencialisht vakumi nga ata që janë në Hagë?

Mavraj: Shiko i nderuar: Që nga 22 korriku 2010 kur Kosova e fitojë rastin në Hagë, në Gjykatën e Drejtësisë, jo në Penale, por në Gjykatën Ndërkombëtare të Drejtësisë,



ShBA-ja në një farë mënyrë është tërhequr nga Kosova dhe ia kanë lënë Evropës. Paralelisht janë aktivizuar dy linja: ajo politike, dhe kjo për krijimin e Gjykatës Speciale nëpërmjet atij raporti të paguar ruso-serb të Dick Martyt. Dhe, këto dy linja janë përputhur në vitin 2019. Rrjedhimisht, duke i njohur shumë mirë karakteret politike të krejt këtij procesi kompleks, e kam thënë, e përsëris, kam qenë i bindur dhe jam i bindur se, kjo, në fakt, pra kjo Gjykatë Speciale është parti speciale politike, parti speciale, -sepse, me shfaqjen e saj do të rikonfigurohej skena politike e Kosovës dhe Kosova do të shkonte në këtë drejtim që po shkon tani. Dhe, cili është ky drejtim? Ata që janë të arsyeshëm dhe munden në mënyrë gjakftohtë t'i vëzhgojnë gjërat, por edhe t'i nxjerrin rezultatet, e shohin se Kosova është distraktuar, ka dalë nga binarët e vet, dhe është 100% në atë linjën që ia vjedh kohën Kosovës, për një kohë bukur të gjatë, ka të paktën 10 vjet që po luftohet në këtë linjë dhe që po luftohet shumë, që Kosovën ta nxjerrë nga koha, në funksion të kohës...

KlanKosova: Për interes të kujt?
Mavraj: Sa më shumë që zvarritet çështja e Kosovës, në funksion të kohës, Kosova është humbëse. Fituesit mund t'i numëroni, por Kosova është humbëse sa më shumë që zvarritet çështja e saj për sa i përket cakut të saj. Serbia e ka cakun e vet, ne e kemi cakun tonë. Cili është caku jonë? E thashë. Caku ynë është integrimi euro-atlantik. Nuk do të integrohemi as në BE, as në NATO e as në organizata tjera ndërkombëtare dhe as do të marrim njohje të rëndësishme ndërkombëtare me këto politika. Ky burri (Hashim Thaçi) që erdhi dje, atëherë e pat lënë Kosovën me 117 njohje. Kosova është bash qaty ku e ka lënë ky zotni me partnerët e tij politikë.

KlanKosova: A nuk u proklamua Kurti si shpëtimtar i Kosovës si njeriu që do ta shtyjë përpara Kosovën?
Mavraj: Na duhen fakte! Na duhen fakte! Faktet janë krejtësisht tjera. Ne tani jemi nën sanksione. Është viti i tretë. Tash jemi në vitin 2025. Është viti i tretë që ne jemi nën sanksione...

KlanKosova: Masa i thotë “babë”, e thirrën “babë” sa herë e sa herë gjithandej Kosovës...
Mavraj: Mund ta thërrasin babë, mund ta thërrasin nanë, mund ta thërrasin si të duan, por anija e Kosovës nuk po shkon atje për ku është nisur dhe perspektiva është jooptimiste me këtë kurs që po vazhdon, por që nuk do të vazhdojë pafundësisht. Kosova është disi pezull...

KlanKosova: Si është e mundur që një njeri me ndjek këtë kurs, i



cili po ashtu ka qenë i përvuajtur? Pra flasim për kryeministrin Albin Kurti, i burgosur politik...
Mavraj: Nuk do të vinte në pushtet pa e ndjekur këtë kurs, në mënyrë absolute, qoftë brenda, qoftë...

KlanKosova: Atëherë pse nuk e ndërrojë kur erdhi në pushtet?
Mavraj: Pse ta ndërrojë? E ndërroi, por e ndërroi negativisht.

KlanKosova: Në aspektin pozitiv është fjala?
Mavraj: Në aspektin pozitiv nuk e ka ndërruar, ai aty nuk është vetëm dhe është bashkë me një staf të gjerë politik dhe...

KlanKosova: Është peng i dikujt?
Mavraj: Urdhëro?

KlanKosova: Është peng i dikujt?
Mavraj: Nuk e di. Koha do ta tregojë nëse është peng ose është diçka tjetër, por tash për tash rezultatet janë këto që janë dhe askush nuk ka përse të habitet ose askush s'ka pse të pres me këtë kurs që do të...

KlanKosova: Ju po ashtu e njihni Albin Kurtin sepse keni qenë bashkorganizator të protestave...
Mavraj: I njohë të gjithë, i njohë të gjithë. Tjetër gjë janë fjalët, tjetër gjë është momenti kur vjen në pyetje prova. Teorikisht këta kanë qenë...

KlanKosova: A është patriot tash Albin Kurti?
Mavraj: Nuk e di a është patriot, duhet të matet me vepra...

KlanKosova: Veprat çfarë thonë?
Mavraj: Veprat thonë se jemi aty ku e ka lënë Thaçi Kosovën: Në ato organizata, me ato njohje, poor, për më keq, tash nën sanksione ekonomike, të izoluar, të ftohur, me besim të thyer me aleatin tonë më të madhin në botë, më të rëndësishmin, shpëtimtarin,- Shtetet e Bashkuara të Amerikës, dhe kjo është sikur mes dy njerëzve që çojnë jetë të gjatë bashkë dhe thyhet besimi...

KlanKosova: ...numërove krahasimet...
Mavraj: ...Nuk kthehet lehtë ky besim, sepse tash ka ndodhur çfarë ka ndodhur. I kemi pesë vite që ende jemi të izoluar. Ende më dhemb shumë në shpirt mandati katërvjeçar i Joe Bidenit që na shkoi tërësisht bosh dhe ende kam frikë se nuk do të vijë një mik më i madh i Kosovës në Shtëpinë e Bardhë, si drejtues, sesa ai njëri që kishte, - po e them për të 100-tën herë, - përveç tjerash, edhe lidhje shuumë familjare, shuumë intime me Kosovën për shkak të të birit. Nëse ju kujtohet, ai ishte njeriu që e siguroi më shumë përpjekje votën pro të Kongresit Amerikan, -të Senatit, për bombardime, dhe menjëherë të nesërmen kanë filluar bombardimet për Kosovën, më 24 mars 1999, e kështu më radhë. Një mik shumë i madh, që as nuk na uroi, as nuk na erdhi dhe as nuk na priti. Dhe e dinim se kështu do të ndodhte. As i ka uruar për fitoren në zgjedhje, as tani, askush, dhe as i ka fituar, dhe as nuk ka ardhur kush. Kur ishte zëvendëspresident ishte këtu, por erdhi me Thaçin. Bëri vizitë tek monumenti i të birit atje, ku edhe një rrugë...

KlanKosova: Ku është emëruar edhe rruga...
Mavraj: Ku një një rrugë mori emrin e të birit të tij, e kështu me radhë. Por, kur u bë president, Kosova veç ishte në raporte shumë të ftohura me Shtëpinë e Bardhë, me ShBA-në. U tërhoq ai staf yni që ishte në ShBA. Mbeti një ambasadë minimale e Kosovës, pa lidhje (me aktorët e politikës amerikane) dhe krejt territoret tona (diplomatike) që i kishim me lobime i mori Serbia nëpërmjet Marko Gjuriqit dhe përfaqësuesve tjerë dhe ekipeve tjera lobuese, ndërkohë që Kosova nuk e ka as edhe një kontratë të vetme lobuese në ShBA. Serbia i ka bërë pesë. Dhe, gradualisht pikat tona, miqësitë tona po i rrëmben, bizneset amerikane po i fton në Serbi, po i rrëmben, por jo edhe Kosova. Kush din të mendojë me kokën e vet, kush guxon të ketë autonomi

të mendimit nuk beso se qëndron larg këtyre pikëpamjeve që po i them këtu.

KlanKosova: Dhe, krejt për fund, megjithatë Albin Kurti prapë ka fituar. Ka dalë i pari në zgjedhje dhe mbase pritet ta bëjë edhe një herë një qeveri, të tretën, Kurti 3...
Mavraj: Kësaj radhe nuk është fitues absolut, është fitues relativ, dhe do ta ketë shumë të vështirë ta bëjë qeverinë, por as e pamundshme nuk është. Ka mjaft formula që mund të shqyrtohen në tryezë nëse këto parti politike janë të pjekura dhe e qesin shtetin përpara vetes së tyre, egove të tyre, partive të tyre politike. Në fund të fundit, mund ta gjejnë një kandidat konsensual dhe ta shmangin Kosovën nga zgjedhjet reja, qoftë për shkak të dështimit të formimit të institucioneve, qoftë për shkak të vitit të ardhshëm kur do të jetë zgjedhja e kryetarit të shtetit. Ka mjaftë opsione, por duhet pjekuri dhe burri. Edhe burri. Burrni shtetërore. Kosova, aktualisht, nuk ka burrështetas.

KlanKosova: As njeriu që ka fituar më së shumti vota në histori të shtetit?
Mavraj: Jo, nuk po sillet si njeri që meriton të quhet burrështetas dhe nuk po sillet si kryeministër i të gjithëve, por kryeministër i një pjese të vogël (të qytetarëve) dhe ky është një lëshim i madh historik i tij...

KlanKosova: Çfarë epiteti meriton ai?
Mavraj: Jeta nuk të sjellë shpesh këso mundësish kaq të mëdha çfare i pati për këto 5-6 vite.

KlanKosova: Është shpërdorues i madh?
Mavraj: Po, patjetër. Po, patjetër.

KlanKosova: Dhe, krejt për fund, tek kjo temë, meqenëse shokë i ke të gjithë liderët e subjekteve politike, përjashtoj mbase Lumir Abdixhikun, a besoni se duhet të shkojë ndonjëri prej tyre në koalicion me Albin Kurtin?
Mavraj: Çfarëdo formule që e ofron Kosovën me aleatët e saj historikë, që i heq sanksionet dhe që na drejton drejt NATO-s dhe BE-së për mua është e pranueshme. Por, aktualisht një pjesë e skenës politike të Kosovës nuk i ka faaare në mendje këto prioritete.

KlanKosova: Vetëvendosja?
Mavraj: Mbase!

KlanKosova: Zoti Mavraj, faleminderit shumë që të kisha në studio!
Mavraj: Respekt! Faleminderit shumë për ftesën.

KlanKosova: Do të ndërrojmë tani temë dhe do të flasim për protestën që po paralajmërohet për nesër në Beograd kundër presidentit të atjeshëm Aleksandër Vuçiç...

PRANOHEN ME SHKRIM DEKLARATAT E DY DËSHMITARËVE NË RASTIN E LIDERËVE TË UÇK-së

HAGË, 17 MARS - Në Dhomat e Specializuara të Kosovës (DhSK), e njohur si Gjykata Speciale në Hagë, është marrë vendim për t'i pranuar në prova materiale disa deklarata me shkrim të dy dëshmitarëve sipas Rregullës 153 në rastin ndaj Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Rexhep Selimit dhe Jakup Krasniqit.

Rregulla 153 parasheh pranimin e deklaratave me shkrim pa u paraqitur dëshmitari në gjykatë për të dhënë dëshmi në rast se dëshmia e tij nuk ka të bëjë drejtpërdrejt me veprimet dhe sjelljen e të akuzuarit për të cilën flet aktakuza, raporton "Betimi për Drejtësi".

Sipas vendimit të 13 marsit 2025, ZPS-ja më 27 shkurt 2025 kishte paraqitur kërkesë për pranimin e dëshmisë së dëshmitarit W02677 sipas Rregullës 153, e ngjashëm edhe për dëshmitarin W04436.

Ndaj kësaj kërkesë nuk kanë reaguar katër ekipet mbrojtëse që përfaqësojnë të akuzuarit.

ZPS-ja kishte parashtruar se tanimë Paneli ka gjetur se deklarata e ZPS-së me W02677 është relevante, autentike në dukje, provuese dhe e përshtatshme për t'u pranuar sipas Rregullës 154. Andaj, ZPS-ja kishte pranuar një propozim nga mbrojtja për pranimin e një deklarate të po këtij dëshmitari sipas Rregullës 153.

ZPS-ja kishte parashtruar se deklarata e këtij dëshmitari përmbush të gjitha kërkesat e pranueshmërisë.

ZPS-ja gjithashtu kishte kërkuar që intervista e vitit 2010 e dëshmitarit W04436 të pranohet si dëshmi sipas rregullës së lartpërmendur. Ata kanë theksuar se kanë zbatuar një vendim të panelit dhe kanë shpërndarë versionin e gjuhës shqipe të kësaj deklarate. "Për më tepër, ZPS-ja sqaroi se nuk ka ndërmend të paraqesë kërkesë për Rregullën 153 në lidhje me W04395", është thënë në vendim.

Sa i përket dëshmitarit W02677, në vendimin e tij, paneli ka theksuar se më 16 prill 2024 ata kanë miratuar pranimin e deklaratës së tij sipas Rregullës 154 duke konstatuar se është



relevante, autentike dhe ka vlerë provuese. Ndërsa, tani ZPS-ja kërkon pranimin e një deklarate tjetër të këtij dëshmitari por sipas Rregullës 153, pas propozimit nga mbrojtja. "ZPS gjithashtu paraqet se pranimi sipas Rregullës 153 do të shmangë stresin e panevojshëm, shpenzimet dhe shqetësimet e tjera në jetën e dëshmitarit, duke përfshirë mundësinë e re-traumatizimit", është thënë në vendim.

Për këtë deklaratë, ZPS-ja kishte parashtruar se është e mbështetur nga dëshmitë e dëshmitarëve dhe të tjerë dhe dokumente të ndryshme duke përfshirë edhe dëshmitarë që mbrojtja e të akuzuarve e kishte mundësinë që t'i përballte.

Paneli ka treguar se kjo deklaratë i ka 33 faqe në anglisht dhe nuk është e përsëritshme dhe përmban kryesisht dëshmi bazë të krimit që ka lidhje me prova për çështje të tjera përveç veprimeve dhe sjelljes së të akuzuarve për çka i ngarkon aktakuza.

Gjithashtu, paneli ka konstatuar se deklarata e dëshmitarit W03677 në dukje është provuese dhe nuk është shumë e dëmshme e si rrjedhojë kërkesat për gjykim të drejtë dhe të

shpejtë kërkojnë pranimi e saj në prova materiale pa mundësinë e kundërpvetjeve nga palët.

"Për këto arsye, paneli gjen se deklarata e W02677 është e pranueshme sipas Rregullave 138(1) dhe 153 pa mundësinë e kundërpvetjeve", është thënë në vendim.

Ndërsa për deklaratën e dëshmitarit W04436, ZPS-ja ka parashtruar se e ka shpërndarë për palët versionin shqip të nënshkruar nga vetë dëshmitari. Sipas vendimit, më 14 shkurt 2025 ishte miratuar pjesërisht kërkesa e ZPS-së për pranimin e dëshmisë së këtij dëshmitari sipas Rregullës 153. Arsyeja se pse kjo kërkesë nuk ishte pranuar në tërësi, sipas vendimit ishte se deklarata e dëshmitarit s'i ka përmbushur kërkesat sipas Rregullës 153, pikës 2 dhe kështu pranimin e saj e ka shtyrë derisa ZPS-ja t'i plotësojë këto kushte.

Pasi janë plotësuar këto kushte, paneli ka gjetur se deklarata e dëshmitarit W04436 është e pranueshme sipas Rregullave pa mundësinë për kundërpvetje. "Për arsyet e mësipërme, Paneli vendos: a) miraton kërkesën; b) pranon në dëshmi, pa mundësinë e pyetjeve kryqëzuese, elementët e

mëposhtëm, përfshirë çdo përkthim të tyre: (i) deklaratën e W02677; dhe (ii) deklaratën e W04436", thuhet në vendim.

Ndryshe Zyra e Prokurorit të Specializuar (ZPS), më 30 shtator 2022 ka dorëzuar aktakuzën e konfirmuar të ndryshuar ndaj Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Jakup Krasniqit dhe Rexhep Selimit, e cila përbëhet nga dhjetë pika me akuza, ku këta të fundit ngarkohen kinse për krime lufte e krime kundër njerëzimit.

Më 29 prill 2022, Zyra e Prokurorit të Specializuar kishte dorëzuar një aktakuzë të ndryshuar ndaj Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Rexhep Selimit e Jakup Krasniqit, ku pretendohet se katër të akuzuarit kanë kryer krime lufte edhe në Gjilan, Budakovë e Semetishtë.

Më 9 nëntor të vitit 2020, në paraqitjet e tyre të para, Jakup Krasniqi e Hashim Thaçi janë deklaruar të pafajshëm për akuzat që u vihen në barrë. Njëjtë është deklaruar edhe Veseli në paraqitjen e tij më 10 nëntor, sikurse edhe Rexhep Selimi më 11 nëntor.

Aktakuza ndaj Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Rexhep Selimit dhe Jakup Krasniqit është konfirmuar më 26 tetor 2020.

U vazhdohet paraburgimi Jakup Krasniqit dhe Rexhep Selimit

Dhomat e Specializuara të Kosovës (DhSK) në Hagë ua kanë vazhduar paraburgimin edhe për dy muaj të tjerë Jakup Krasniqit dhe Rexhep Selimit.

Vendimi është marrë më 13 mars 2025 nga kryetari i trupit gjyqes Charles Smith III.

Për të dy të akuzuarit, paneli i gjyqtarëve ka konstatuar se nuk ka mjaftueshëm informacione se ata mund të ikin nga drejtësia, mirëpo ekziston rreziku që ata ta pengojë zhvillimin e procedurave të DhSK-së si dhe të kryejnë krime të tjera. Këto krime, sipas gjyqtarëve, ka rrezik të kryhen ndaj atyre që perceptohen si kundërshtarë të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK), duke përfshirë edhe dëshmitarët që kanë ofruar ose mund të ofrojnë dëshmi gjatë ditëve në vijim.

Andaj, paneli ka konstatuar se asnjë prej kushteve alternative nuk mund t'i zbusin rreziqet ekzistuese përveçse ai i paraburgimit në objektet e DhSK-së.

ZPS-ja për Krasniqin dhe Selimin ka parashtruar se duke marrë parasysh të gjithë faktorët, paraburgimi ndaj tyre mbetet i arsyeshëm.


Po ashtu, edhe paneli ka vlerësuar se ky rast është i ndërlikuar duke marrë parasysh natyrën e akuzave si dhe dënimet e mundshme, po ashtu edhe rreziqet e vazhdueshme për pengim të drejtësisë. Andaj si rrjedhojë ka gjetur se paraburgimi ndaj Krasniqit dhe Selimit është i nevojshëm dhe i arsyeshëm për shkak të rrethanave specifike të rastit.

FSK-ja nis operacionin humanitar për pastrimin e fushave të minuara

Prishtinë, 17 mars - Kompania e Deminimit e Gardës Kombëtare të Forcës së Sigurisë së Kosovës (FSK) ka nisur të hënën operacionin humanitar për pastrimin e fushave të minuara dhe fushëbetejave, me qëllim sigurimin e zonave nga mjetet e pashpërthyer. "Gjatë këtij

viti njësitë e deminimit do të jenë të angazhuara në pastrimin e tri lokacioneve në territorin e Republikës së Kosovës: në fshatrat Muradem dhe Maja e Cvilenit të komunës së Prizrenit si dhe në Parkun e Lirisë në Ferizaj dhe gjithashtu do të ofrojnë kujdestari 24/7 për largimin

e mjeteve të pashpërthyer që mund të hasen nga qytetarët", është thënë në njoftimin e FSK-së. Këto operacione janë pjesë e përpjekjeve të vazhdueshme të FSK-së për të siguruar një mjedis të sigurt për qytetarët dhe për të kontribuar në stabilitetin dhe zhvillimin e vendit.



Kosova mes “çikërrimave politike” dhe rreziqeve të sigurisë



PRISHTINË, 17 MARS - Derisa Evropa riarmatoset, NATO-ja është në krizë dhe aleancat nën presion, siguria në Kosovë vihet në diskutim. Autoritetet garantojnë stabilitet, por ekspertët kanë paralajmëruar për cenueshmërinë e saj dhe u kanë bërë thirrje udhëheqësve të Kosovës të jenë sa më të pranishëm në tryezat ku diskutohet fati i sigurisë. Ministri i Mbrojtjes i Kosovës, Ejup Maqedonci, ka argumentuar se kapacitetet e mbrojtjes dhe sigurisë në vend janë përmirësuar ndjeshëm vitet e fundit. Ai ka theksuar se investimet në personel, pajisje dhe doktrinë kanë luajtur rol kyç në avancimin e Forcës së Sigurisë së Kosovës, duke e bërë atë më të aftë për t'i përmbushur detyrat mbrojtëse dhe për t'u përshtatur me sfidat e reja të sigurisë. Megjithatë, për shkak të ndjeshmërisë së informacionit, Maqedonci është kufizuar në detajet që ndan publikisht dhe përmend vetëm disa prej sistemeve që ka Kosova. “Ne e kemi një flotë të dronëve Bayraktarë. Përveç tyre, kemi prokuruar edhe sisteme të tjera të fluturakeve pa pilotë - që nuk janë bërë publike - dhe vazhdojmë të prokurojmë, me qëllim që t'i përmbushim jo vetëm nevojat operacionale të FSK-së, por edhe të kemi kapacitete të bollshme për çdo ndryshim situatë”, ka thënë Maqedonci për “Radion Evropa e Lirë”. Kosova që nga përfundimi i luftës më 1999 mbështetet kryesisht në forcën paqeruajtëse të NATO-s, KFOR. Në vitin 2018, Forca e saj e Sigurisë ka nisur procesin 10-vjeçar të transformimit në ushtri me kapacitete të plota. Ministri Maqedonci ka thënë se këtë vit pritet të nisë faza e tretë dhe e fundit e tranzicionit dhe thekson se disa objektiva të parapara të arriheshin në vitin 2028, tashmë janë realizuar. Këtu ai ka përmendur sasinë e mjaftueshme të municionit, si dhe përparimet në rekrutimin e personelit. “Tanimë e kemi kaluar numrin prej 4 000 (ushtarësh). Besoj se është mbi 4 300 apo 4 400. Në këtë aspekt, jemi më herët në kohë - pra i

kemi realizuar objektivat më herët sesa që ka qenë e paraparë. Unë besoj se deri në vitin e ardhshëm do t'i kemi 5 000 (ushtarë)”, ka thënë Maqedonci. Deri në fund të transformimit, Forca e Sigurisë së Kosovës pritet t'i ketë mbi 7 500 pjesëtarë - prej tyre 5 000 aktivë dhe të tjerët rezervistë. Nga fillimi i tranzicionit, procesi e ka pasur mbështetjen e Shteteve të Bashkuara, por jo edhe të NATO-s, e cila ka këmbëngulur se FSK-ja duhet t'u përmbahet detyrave të saj fillestare, si: reagimi ndaj krizave apo mbrojtja civile. Këtë qëndrim e përsëriti këtë javë edhe sekretari i përgjithshëm i NATO-s, Mark Rutte, gjatë një vizite në Kosovë. “FSK-ja duhet të ketë gjithçka që i duhet për të qenë efektive në kryerjen e rolit të saj humanitar këtu në Kosovë. Ky është mandati që NATO-ja ka për ta ndihmuar FSK-në - pra të zhvillohet dhe të jetë forcë humanitare në këtë vend, kur ndodhin çështje humanitare. Ky është mandati dhe për këtë punojmë çdo ditë”, ka thënë Rutte. Në përgjigje, presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani, ka thënë se mungesa e njohjes së Kosovës nga katër vende të NATO-s e komplikon avancimin e raporteve mes FSK-së dhe aleancës, por theksoi se FSK-ja, në përputhje me ligjet në fuqi, ka mandat të plotë për mbrojtjen e sovranitetit dhe integritetit territorial të Kosovës. “Përveç kësaj, ne kemi gjetur edhe mënyra të tjera për ta avancuar rolin e FSK-së dhe kontributin e saj për paqe dhe siguri në vende të tjera, nëpërmjet marrëveshjeve të bashkëpunimit që i kemi me shtetet anëtare [të NATO-s] veç e veç”, ka thënë Osmani. Nga gjashtë vendet e Ballkanit Perëndimor, Shqipëria, Maqedonia e Veriut dhe Mali i Zi janë vende anëtare të NATO-s; Serbia dhe Bosnjë-Hercegovina janë pjesë e programit të NATO-s, Partneriteti për Paqe, ndërsa Kosova mbetet jashtë kësaj kornize për shkak të mosnjohjes nga katër vende anëtare: Greqia, Rumania, Sllovakia dhe Spanja. Për rrjedhojë, ajo detyrohet të

mbështetet në marrëveshje dypalëshe, sidomos me aleatë si ShBA-ja dhe Turqia. Përtej kufirit, Serbia - e cila nuk e njeh pavarësinë e Kosovës dhe ka pretendime territoriale ndaj saj - vazhdon ta forcojë ushtrinë me armë si nga Perëndimi ashtu dhe nga Lindja. Kosova e konsideron atë si kërcënim kryesor për sigurinë e saj dhe ka pasur disa raste në vitet e fundit kur ky fqinj ka grumbulluar trupa në kufi. Për t'i shmangur keqkuptimet dhe përshkallëzimin e tensioneve, Katarina Gjokiq nga Instituti Ndërkombëtar për Kërkime të Paqes në Stokholm ka thënë se dy vendet, përveçse duhet ta përmirësojnë komunikimin, duhet ta rrisin edhe transparencën për kapacitetet ushtarake që kanë. “Do të ishte mirë sikur të kishte një ndërmjetës të gatshëm për t'u angazhuar. KFOR-i ka pozicion të mirë - nuk është në mandatin e tij, por është i pranishëm. Pastaj, Bashkimi Evropian e ndërmjetëson një dialog mes Kosovës dhe Serbisë - edhe pse ka ngecur, ai mbetet i përfshirë. Pra, ka hapësirë për kreativitet kur bëhet fjalë për diplomacinë”, ka thënë Gjokiq për programin “Expose” të “Radios Evropa e Lirë”. Për disa ekspertë të sigurisë gjasat e një sulmi ushtarak konvencional ndaj sovranitetit dhe integritetit territorial të Kosovës janë të ulëta, kryesisht për shkak të pranisë së KFOR-it. Por, me luftën e vazhdueshme në Ukrainë, jostabilitetin në Lindjen e Mesme dhe ndryshimin e peizazhit të sigurisë globale, ata thonë se Kosova, medoemos duhet t'i rrisë përpjekjet për transformimin sa më të shpejtë të FSK-së në një ushtri plotësisht operacionale. Adrian Shtuni nga Qendra Ndërkombëtare kundër Terrorizmit ka thënë se kjo nuk është më vetëm një çështje politike, por “një domosdoshmëri urgjente”. “Në këtë moment Evropa është duke u armatosur si kurrë më parë që nga fundi i Luftës së Ftohtë. Kjo nuk është duke u bërë nga dëshira, por nga nevoja, për shkak të kërcënimeve që vijnë nga Lindja, konkretisht nga

Rusia. Dhe Ballkani është në Evropë, përkatësisht në juglindje - pra më afër vendit prej nga vijnë kërcënimet”, ka thënë Shtuni për “Expose”-në. Administrata e presidentit të Shteteve të Bashkuara, Donald Trump, raportohet se është duke konsideruar ripozicionimin e trupave të saj në Evropë. Në të njëjtën kohë është duke shtuar edhe trysninë mbi aleatët evropianë, për t'i rritur shpenzimet ushtarake dhe për të marrë më shumë përgjegjësi për mbrojtjen e tyre. Shtuni ka thënë se kjo thirrje vlen edhe për Kosovën si shtet evropian. “Duhet të bëhet shumë sa i përket transformimit të FSK-së në ushtri. Jemi në kohë tranzicioni, shumë të vështirë, me shumë sfida, që kërkon rritjen e kapaciteteve mbrojtëse edhe nga vendet që kanë strukturë ushtrie prej dekadash apo qindra vitesh, e imagjinojeni se çfarë mund t'i duhet Kosovës”, ka thënë Shtuni. Buxheti i ndarë për Ministrinë e Mbrojtjes në Kosovë ka shkruar duke u rritur nga 67.3 milionë euro në vitin 2021, në 207.8 milionë euro këtë vit. Ministri i Mbrojtjes, Maqedonci, ka thënë se në vazhden e ndryshimeve të fundit gjeopolitike, për katër vjetët e ardhshëm parashikohet një buxhet prej mbi 1 miliard eurosh për mbrojtjen. Por, Shtuni ka shtuar se përballë një politike më të izoluar amerikane, Kosova duhet t'i diversifikojë edhe partneritetet e sigurisë. Ai e ka përmendur planin e Bashkimit Evropian për të shpenzuar 800 miliardë euro në mbrojtje dhe thotë se Kosova duhet të pozicionohet në mënyrë strategjike për të përfituar nga këto fonde dhe për të qenë e pranishme në tryezat ku diskutohet fati i sigurisë. Eksperti i sigurisë është shprehur i indinjuar me faktin që, edhe më shumë se një muaj pas zgjedhjeve, Kosova vazhdon të mbetet e zhytur në debatet për vota. Në kohën kur shumëçka është duke u riformatuar në politikën e jashtme, në politikën e mbrojtjes dhe në rendin global, udhëheqësit e Kosovës merren me “çikërrima të politikës së

brendshme”, sipas tij. “Mendoj se kjo është papërgjegjshmëri. Kosova nuk e ka luksin të zvogëlohet, duhet të zmadhohet, të jetë e pranishme, jo vetëm me fjalime, por në mënyrë aktive, në mënyrë insistuese, strategjike, me partnerë, për të shpjeguar se përse një Kosovë e fortë, më mirë e mbrojtur, më mirë e armatosur, është në të mirën e sigurisë së Evropës. Sepse jo vetëm që do ta arrinte aftësinë për vetëmbrojtje, por do t'i lironte edhe kapacitetet e vendeve të tjera anëtare të NATO-s që janë aktualisht në Kosovë”, ka thënë Shtuni. “Radio Evropa e Lirë” pyeti edhe Departamentin Amerikan të Shtetit, edhe atë të Mbrojtjes, se si do të vazhdojë administrata Trump ta mbështesë transformimin e FSK-së në ushtri, por prej asnjërit institucion nuk mori përgjigje. Të mërkurën e 12 marsit Qeveria e Kosovës ka miratuar në parim lidhjen e një marrëveshjeje me ShBA-në për thellimin e bashkëpunimit në fushën e mbrojtjes. Për ministrin Maqedonci, kjo do të thotë se ShBA-ja do ta ndihmojë Kosovën në ngritjen e kapaciteteve strategjike ushtarake. Nga ky vend, Kosova pret edhe sistemet kundërajrore Javelin - të njohura për aftësinë e tyre për të avancuar kundër mjeteve të blinduara. Maqedonci ka thënë se aktualisht është duke u bërë pagesa e tyre, por nuk specifikon se kur do të arrijnë në Kosovë. Kërkesën për blerjen e mbi 200 kundërajrorëve të tillë, Kosova e ka bërë më 2024. Po atë vit Kosova ka bërë një marrëveshje edhe me Turqinë për ndërtimin e fabrikës së parë të municioneve të kalibrave të ndryshëm. Maqedonci i ka thënë “Radios Evropa e Lirë” në fund të vitit të kaluar, se Kosova për katër vjet ka shpenzuar mbi 269 milionë euro për blerje të armatimit. E për Shtunin çdo moment që ka sfida, ofron edhe mundësi, që udhëheqësit e zgjuar duhet t'i shfrytëzojnë në favor të popullit të tyre. Me fjalët e tij, “gjërat më të mira ndonjëherë vijnë kur je i vendosur me shpatulla për mur, sepse rrethanat janë të atilla që duhet të dalësh me zgjidhje”.

Kompania e taksive vidhte rrymë për veturat elektrike, KEDS-i humb mbi 30 mijë euro

PRISHTINË, 17 MARS - Kompania e Distributimit të Energjisë Elektrike (KEDS) ka zbuluar se një kompani taksish në Fushë-Kosovë po mbushte veturat elektrike pa leje dhe pa regjistruar njehsorin elektrik. Pronari i kompanisë kishte instaluar një njehsor ilegal për të

vjedhur energji elektrike. Kjo kompani ka llogaritur se humbja nga ky rast është 33,500.04 euro, një shumë që kompania e taksive duhet ta paguajë për ta kompensuar dëmin. “Kjo është kompania e dytë e taksive me vetura elektrike të cilën KEDS-i e ka zënë

duke vjedhur rrymën. Kushdo që joshet për ta vjedhur rrymën, le të mendojë dy herë e le të besojë se KEDS-it nuk i shpëton asnjë rast pa u identifikuar. Zero tolerancë ndaj keqpërdoruesve të energjisë elektrike”, ka njoftuar KEDS-i.



REAGIM I KMDLNJ-së

A mund të ndalen kusarët e ZRrE-së?!

Nëse dikush i ka dëmtuar më së shumti qytetarët dhe bizneset e Kosovës dhe nuk është dënua janë piratët grabitës të Zyrës së Rregullatorit të Energjisë (ZRrE), që nga paslufta e sidomos sot. Qeveria Kurti 1 dhe 2 deri më tani i ka rritur faturat e rrymës mbi 130 për qind kurse po kjo qeveri po e shfrytëzon një vakum të krijuar duke e lejuar strukturën zhvatëse ZRrE të rrisë rrymën së paku për 15 për qind shtesë. Para zgjedhjeve qeveria e Kosovës thoshte se rryma nuk do të shtrenjtohet që ishte deklaratë politike mashtruese kurse ZRrE-ja deklaronte gjithashtu se nuk do të ketë rritje të faturave të rrymës e që ishte vetëm alibi për krimin e radhës ekonomik dhe social. Po kjo ZRrE-ja, thuaja për 15 vite i ka vjedhur qytetarët shqiptarë dhe joserbë duke ua fryrë faturat për të kompensuar rrymën e papaguar nga serbët e veriut dhe vendeve tjera në Kosovë. Përkundër një vendimi të gjykatës përkatëse për kompensim kjo është mjegulluar nga ZRrE-ja me disa shifra qesharake dhe as ato nuk janë kompensuar. Pasi u vërtetua se ZRrE-ja gjatë 15 viteve kundërligjshëm ka plaçkitur qytetarët e Kosovës, Prokuroria e Shtetit është dashur të ndjekë sipas detyrës zyrtare keqbërësit apo strukturat kriminale në ZRrE-ja. Nuk mund të arsyetohet hajna me situata apo ambalazhime politike. Është vjedhje flagrante tarifa fikse



prej 2 eurove me të cilën ngarkohen mbi 470.000 njehsorë e që kjo vjedhje nuk po hetohet. Plaçkitja më e madhe bëhet në kohën e dimrit kur manipulohet me tarifa që askush nuk ka mundësi t'i kontrollojë . Pse do të duhej të paguajnë çmime ndëshkuese qytetarët apo bizneset që shpenzojnë mbi 800 Kw ?! Shpenzuesit e mëdhenj duhet të jenë status të privilegjuar e jo trajtim diskriminues. Është në

kundërshtim me të drejtat e njeriut për trajtim të barabartë dhe jodiskriminues. KMDLNJ-ja në vazhdimësi ka kundërshtuar veprimet e ZRrE-së dhe qeverive mandate për shpërdorim të çmimeve të rrymës e që janë në shpërputhje të madhe me mundësitë materiale të qytetarëve të Kosovës. ZRrE-ja , që nga përfundimi i luftës ka qenë në shërbim të mafies energjetike dhe strukturave të korruptuara qeveritare prandaj

ka qenë dhe është përjashtuar nga çdo përgjegjësi penale. KMDLNJ-ja ka thirrur qytetarët e Kosovës të kundërshtojnë në mënyrë të organizuar këto keqpërdorime nga ZRrE-ja dhe Qeveria e Kosovës përmes organizimit të protestave dhe mënyrave tjera të kundërshtimit demokratik dhe paqësor siç janë bllokimi i zyrave të ZRrE-së apo ministrive përkatëse. Paralajmërimi për kundërshtim përmes nënshkrimit të

peticionit nuk do të prodhojnë asnjë efekt parandalues , më shumë i përshtatet strukturave kriminale të ZRrE-së dhe strukturave të korruptuara të qeverisë. Vetëm protestat masive dhe jashtë çdo ndikimi politik mund të parandalojnë veprimet shpërfuruese të ZRrE-së dikur edhe t'i rikthejnë të drejtat e mohuara të qytetarëve të Kosovës që nga përfundimi i luftës duke ua kompensuar mjetet e vjedhura nga ZRrE. KMDLNJ-ja tërheq vërejtjen se pas rritjes eventuale të çmimit të energjisë elektrike që ka paralajmëruar pirateria e ZRrE-së, do të rriten në mënyrë zinxhirorë dhe të pakontrolluar çmimet e artikujve tjerë dhe të gjitha shërbimeve duke rritur tej mase varfërinë e pjesës dërrmuese të qytetarëve të Kosovës. Asnjë qeveri e më së paku kjo e tashmja nuk e ka bërë indeksimin e pagave, pensione, skemave sociale, kredive studentore në përputhje me shkallën e inflacionit si pasojë e rritjes së çmimeve. KMDLNJ-ja përkujton qytetarët e Kosovës se ata kanë përgjegjësi t'i mbrojnë të drejtat e njeriut në rast se këtë nuk e bën ligji që e ka detyrim ta bëjë këtë. Në rastin konkret ligji ka dështuar t'i mbrojtë të drejtat e qytetarëve , pa asnjë dyshim. Ndryshe ZRrE-ja do të ishte institucion që mbron të drejtat e qytetarëve - konsumatorëve e jo institucion që mbron të drejtat e mafies energjetike dhe strukturave të korruptuara qeveritare.

Oda Ekonomike kërkon shtyrjen e vendimit për shtrenjtimin e rrymës

PRISHTINË, 17 MARS - Kryetari i Odës Ekonomike të Kosovës (OEK), Lulzim Rafuna, ka kërkuar të shtyhet vendimi për shtrenjtimin e energjisë elektrike së paku për një vit pasi, sipas tij, vendimi është marrë në kohë të shkurtër dhe nuk ka pasur kohë që bizneset të përgatiten. Rafuna ka thënë se në takimin me bizneset, kërkesa e tyre ka qenë që të shtyhet ky vendim si dhe që institucionet e Kosovës ta subvencionojnë sektorin e prodhimit. “Patëm një mundësi

t'i dëgjojmë shqetësimet e bizneseve. Shqetësimet më të mëdha ishin te bizneset e prodhimit, ku do të ketë efekt zinxhiror, do të rritë koston e produktit që më pas do të bartet te konsumatori. Është kërkesë të shqyrtohet mundësia të shtyhet të paktën për një vit ky vendim. E dyta kërkesë drejtuar institucioneve të Kosovës është që sektori i prodhimit të subvencionohet. Kërkesa e të gjithëve është që të shtyhet së paku për një vit implementimi i këtij vendimi, sepse ka sfida të

tjera dhe kjo sfidë shtesë është shumë. Do të ketë rritje të papunësisë dhe tkurrje të prodhimit vendor të Kosovës. Kërkesa e OEK-ut është që kjo të shtyhet. Nuk jemi kundër vendimit, por koha është shumë e shkurtër. Nuk ka pasur kohë që biznesi të përgatitet. Kërkesa tjetër që vjen për partitë politike është sa më shpejt t'i kemi të themeluara institucionet e vendit, në mënyrë që të kemi kujt t'i drejtohem”, ka thënë Rafuna në konferencë për medie.



DEMONSTRATAT E VITIT 1981 NË KOSOVË, SIPAS REVISTËS GJERMANE “DER SPIEGEL” (4)

JUGOSLLAVIA – TË GJITHË HESHTIN




Shkruan: Mr. sc. Naim J. KRASNIQI

Edhe pse kishin kaluar më shumë se gjashtë muaj, situata në Kosovë assesi po qetësohej, por çdo herë vinte duke u rënduar. Ndjekjet dhe arrestimet kishin hapur një gamë të madhe veprimesh, dënimesh, apo siç njihet, diferencimi politik ndaj shqiptarëve kishte përfshirë gjithë sistemin arsimor, kulturor dhe atë akademik. Pas masave politike, pasonin largimet nga vendet e punës. Dokumenti i Komitetit Qendror të LKJ, filloi t’i jepte “rezultatet e veta”. Masat drastike filluan edhe ndaj gazetarëve (ata të cilët kishin guxim të shkruanin apo raportonin diçka që nuk shkonte për shtat me Partinë).

Analiza e këtij numri merret me zhvillimet e fundit që ndodhnin në Kosovë. Revista fillon kështu: “Beogradi nuk po arrin të kontrollojë trazirat në rajonin e Kosovës. Që nga marsi, shqiptarët e Kosovës janë rebeluar kundër pushtetit serb. Në jug të Jugosllavisë, deri në kufirin me Greqinë, ndodhi një ndërprerje totale e energjisë elektrike. Që nga koha kur disa nga centralet elektrike në rajonin e Kosovës u dëmtuan papritur, rrjeti i energjisë në Jugosllavi ka kalopuar. Pavarësisht këtij dështimi të vazhdueshëm të furnizimit me energji, ndriçimi i rrugëve, reklamat e bizneseve dhe ngrohja (edhe pse ishte shpërndarë në pjesën qendrore të Prishtinës – N.K.) janë ndërprerë për shkak të mungesës së energjisë, duke prekur zona të tëra në Beograd”. Edhe kjo çështje nuk mbeti pa u politizuar nga shtypi i Beogradit, ku gazeta që merrej me çështjet ekonomike në nivel të Jugosllavisë, “Ekonomiska Politika” (Ekonomia Politike) shtronte pyetjen: “Pse nuk dimë asgjë për termocentralet elektrike të Kosovës, ndryshe nga të tjerët që raportohen për çdo dështim?”

Për sa i përket situatës në Kosovë, energjia elektrike që kishte arritur të prodhohej ra në më pak se një milion kilovat-orë, duke rënë ndjeshëm nga kapaciteti i duhur. Një përfaqësues i shtetit, Milorad Stanković, përmend lidhjen midis krizës energjetike dhe rebelimit, duke thënë se nacionalistët shqiptarë janë organizuar dhe po realizojnë akte të shkatërrimit – sabotimit. Pra, filluan shkrimet për sabotimet që mendoheshin se

ishin të organizuara dhe po respektonin kërkesën apo parullën që ishte parë gjatë demonstratave të marsit dhe prillit në fillim të këtij viti: “Kosova punon – Serbia ndërton” apo “Trepça punon – Beogradi ndërton” dhe autori vazhdon me këto të dhëna: “Në disa qytete të Kosovës, si në Gjilan, shërbimet sekrete po kërkojnë sabotatorët që janë të përfshirë në shkatërrimin e fabrikave dhe infrastrukturës. Fabrikat po digjen, vila e një funksionari u sulmua, dhe gjithashtu edhe tentativat për të djegur makinën e tij dështuan, duke u shpërndarë në errësirë”. Përmes këtij shkrimi të “Ekonomiska Politika” (Ekonomia Politike), gazetatat e Beogradit filluan t’i sulmonin gazetarët dhe udhëheqësit në Kosovë që nuk po raportonin në mënyrë korrekte për këto fenomene, duke vazhduar: “Disa gazetarë dhe udhëheqës të partisë (dhe strukturave të tjera politiko-shoqërore) po heshtin, pa zbuluar identitetin e autorëve të këtyre sulmeve dhe shkatërrimeve. Gazetaria dhe regjimi janë të heshtur për sa i përket këtyre ngjarjeve”, duke vazhduar me rrjedhën e ngjarjeve të pranverës që kishin ndodhur, si dhe qëndrimet e shqiptarëve dhe serbëve që ishin po thuajse hakmarrëse për shkak të raporteve të këtyre popujve gjatë historisë; “...trazirat filluan me një protestë studentore në Prishtinë për kushtet e këqija në konvikte, dhe më pas përshkallëzuan në kërkesa për barazi për shqiptarët e Kosovës, që përbënin shumicën në këtë provincë. Ata kërkonin një republikë të pavarur brenda Jugosllavisë. Megjithatë, autoritetet serbe, duke e parë si kërcënim për shtetin, vendosën forca policore dhe ushtarake që të intervenonin, duke sjellë rritjen e tensioneve dhe dhunës. Në fund, Serbia u mundua të justifikonte ndërhyrjen e saj në Kosovë duke pretenduar se ky ishte një akt i domosdoshëm për të ruajtur rendin”. Kështu, Serbia duke arsyetuar para opinionit të brendshëm dhe atij ndërkombëtar për masat represive që kishte kundër shqiptarëve dhe Kosovës, dhe filloi me propagandën e saj kundër veprimtarëve të emigracionit politik shqiptar. “Shtypi dhe propaganda qeveritare u përpoqën të fajësojnë për situatën emigrantët shqiptarë dhe shërbimet e huaja”. Kjo propagandë bëhej nëpër gazetatat që trajtonin tema politike, ndërsa ...gazetat po japin këshilla për mënyrat se si mund të shpëtohen ushqimet që janë ngrirë dhe po shkrihen. Gazeta që ishte organi udhëheqës ekonomik të Jugosllavisë, “Ekonomiska Politika”, ka prekur një “tabu”: ishte “te çuditshme” që nuk kishte informacione të sakta për centralet elektrike të



Kosovës, “pavarësisht se për çdo central tjetër në vend dihet pse është prishur, sa do të zgjasin riparimet dhe sa qymyr ka në magazinë”, prandaj kjo gazeta propagandonte se këto avari janë sabotime politike dhe vazhdon: “Për sa i përket furnizimit me energji në rajonin e Kosovës, ku shqiptarët ishin rebeluar në pranverë, ka vetëm një shifër: në vend që të prodhoheshin 2.4 milion kilovat-orë energji elektrike për Serbinë çdo ditë, tani ato centrale po japin më pak se një milion”. Këtë analizë, autori e forcon me deklaratën e një politikani serb të Kosovës: ... Milorad Stanković, i cili i sugjeroi shefit të shërbimeve të sigurisë në qytetin kosovar të Ferizaj, se: “Aktiviteti i nacionalistëve dhe irredentistëve shqiptarë nuk tregon shenja të dobësimit. Armiqtë tani po organizohen në grupe të vogla, dy ose tre veta. Në parullat dhe pamfletët e tyre po bëhet thirrje për sabotazh dhe nderje zjarresh”. Duke vazhduar: “Në Gjilan, një qytet tjetër në Provincën shqiptare të Jugosllavisë, shërbimi i sigurisë ka ndjekur sabotatorët në një fabrikë duhani, në një kombinat tekstili dhe te një ndërmarrje që prodhonte sisteme ngrohjeje. Sipas gazetës lokale të partisë, (mendoj se është fjala për gazetën „Rilindja“). “Të gjithë e dënojnë këtë veprimtari subversive, por të gjithë heshtin. Nuk është çudi që mbishkrimet armiqësore shfaqen edhe në shtëpitë e liderëve të organizatave shoqërore e politike – por nuk kanë mundur të zbulohet autori.” Për aktivitete subversive, gazeta beogradase vazhdon me propagandë të stilit apo mësimave dhe direktivave të

UDB-së; “Fabrikave u vënë flakën, vila e një funksionari të shërbimeve të sigurisë u dogj. Gazetat njoftuan një sukses: atentatorët u ndaluan të ndezin makinën e funksionarit, por ata u zhdukën në errësirë.” Ky konstatim i gazetës së Beogradit ishte një ogur i zi për shqiptarët. „Vetëm me “guxim dhe gjakftohtësi të jashtëzakonshme”, udhëheqësit (lokomotivistët) e trenave guxojnë ende të udhëtojnë natën në shinat që çojnë në rajonin e Kosovës: Në shina ka gurë, sistemet e sinjalizimit janë shkatërruar, dhe projektile të rrezikshme po thejnë xhamat e trenave. Edhe ushtarët nga pjesë të angazhuar. Protestat e pranverës i shqetësuan shumë udhëheqësit në Beograd, duke klithur, se Federata është në rrezik, për ekzistencën e shtetit.“ Autori jep edhe të dhëna për dëmet materiale – xhama të thyer, ekspozita mallrash të shkatërruara, automjete të rrokullisura dhe të vëna në flakë – që, sipas vlerësimeve të Beogradit, dëmi ishte shumë i madh. Specialistët e sigurimeve në rajonin e Kosovës nuk u pajtuan me deklaratimet e Beogradit për një humbje në vlerë prej 700,000 marka. Ata (specialistët kosovarë) të cilët e vlerësuan dëmin material thanë se këto shifra janë shuma të ekzagjeruara. Kryetarët lokalë të partisë, madje edhe punonjës të shërbimit të sigurisë (të Kosovës), ishin shumë të angazhuar në refuzimin e ofertave të Beogradit për “ndihmë vëllazërore” nga Serbia për ndjekjen dhe arrestimet e demonstruesve. Për këtë qëndrim të ftohtë (nga ana e Serbisë), u vlerësua se kemi të

bëjmë saktësisht me rrezikun për shtetin, prandaj filluan debatet nga Partia dhe administrata shtetërore. Ata (është fjala për shqiptarët) tani po humbin një pas një pozitë e tyre. Sepse, pavarësisht paralajmërimeve nga njohës të kushteve lokale, se një okupim serb do ta sfidonte më tej popullatën shqiptare, në fund të marsit, forcat policore serbe dhe njësitë ushtarake të trajnuara për luftë (speciale) të afërt erdhën dhe u vendosën në Kosovë. Pushtimi duhej të mbetej një sekret. Edhe pas disa javësh nga pushtimi, as popullata jugosllave nuk ishte informuar për këtë; rajoni mbeti për muaj të tërë i mbyllur (i izoluar), jo vetëm për turistët e huaj, por edhe për gazetarët e brendshëm, edhe pse ata ishin besnikë të partisë. Të dhënat e mëvonshme të shtypit dhe partisë mbi numrin e viktimave gjatë përplasjeve të para midis kryengritësve dhe pushtuesve ishin të ndryshme. “Nga Kosova, në redaksinë tonë erdhi një ‘Apel për ndërgjegjen e gjithë botës së civilizuar’, i nënshkruar nga tre profesorë universitarë dhe shkencëtarë, ku ndër të tjera shkruhej: „Gjatë muajve mars dhe prill, dy rrugët kryesore të Prishtinës, ‘Ramiz Sadiku’ dhe ‘Marshala Tita’, treguan pamje tmerruese: trupa të shpërndara, shpesh të copëtuara dhe të shkatërruara, pa kokë, këmbë dhe duar, ndër të vdekurit edhe fëmijë në moshën e shkollës fillore. Këto ishin gjurmët e fundit të masakrës, të kryer nga ushtria jugosllave dhe milicia. Shumë trupa u ngarkuan nga ushtria në kamionë dhe u dogjën jashtë qytetit me naftë.“ Mundësitë për të verifikuar këto të dhëna nuk ekzistojnë, pasi,

siç pohojnë autorët e apelimit, emrat e të cilëve janë të njohur për SPIEGEL, „qeveria ka vendosur ligjin ushtarak mbi rajonin e Kosovës: Amnesty International dhe Kryqi i Kuq Ndërkombëtar nuk patën mundësinë të hyjnë.“ Të tre dëshmitarët shkruesit e këtij „Apeli“, duke iu referuar pakicës shqiptare në Jugosllavi, „...e cila nuk është në gjendje të lidhet drejtpërdrejt me botën e jashtme“, dhe vazhdojnë: „Raportimet zyrtare përçojnë vetëm pamje të zbehta të masakrës që ka ndodhur në provincën tonë të pafat. Të drejtat qytetare nuk vlejnë më, natën ushtria patrullon rrugët. Ne nuk mund ta vlerësojmë numrin e atyre që janë arrestuar, por do të jetë më shumë se një mijë“, theksohet në këtë „Apel“.

Sipas gazetave të Beogradit, rreth 2000 shqiptarë janë “administrativisht” të dënuar, që do të thotë: pa gjykim dhe mbrojtje, me dënime me burg. Po ashtu, deri më 31 gusht, 245 persona morën dënime me burg deri në 15 vjet; në fillim të shtatorit u shtuan edhe 50 dënime të tjera, me një dënim mesatar prej nëntë vitesh. Por çfarë aktiviteti politik kishin bërë këta të dënuar, pyet autori i analizës dhe fillon shkrimet për shkaqet e dënimit. „Për shkak se ‘ka shkruar dhe kënduar tekste armiqësore’, nxënësi Daut Rashani, 18 vjeç, mori 6 vjet burg, ndërsa studenti Skender Ahmeti, 21 vjeç, mori 11 vjet, dhe shoku i tij Merxhan Abdyli, ishte dënuar me 15 vjet burgim, sepse ai kishte shkruar dhe lexuar një letër proteste drejtuar qeverisë.“

„Drejtori i teatrit (është fjala për Drejtorin e Shtëpisë së Kulturës në Drenas, Hajzer Gjoshin N.K.), sepse kishte larguar fotografën e Titos dhe e kishte vendosur në një vend tjetër, ky u dënuar me gjashtë vjet burg, ashtu si edhe redaktorët që kishin të kaluar kritika për regjimin, por edhe autori i një shkrimi kritik për sjelljen e organeve të rendit gjatë shpërndarjes së

demonstratave; ky është shkrimtari dhe gazetari Sabit Rustemi.“

Bujku Nagib Blaca shkoi në burg për dymbëdhjetë vjet për “kontrarevolucion”, ndërsa qepësja Dinore Curi, 19 vjeçe, u dënua me njëmbëdhjetë vjet për pjesëmarrje në një demonstratë. Polici Bajram Gashi, 22 vjeç, i cili, si shumë shokë të tij shqiptarë, kishte marrë anën e popullit të tij, u dënua me pesëmbëdhjetë vjet burg.

Detajet e arsytimit të dënimeve kundërshtojnë atë që propaganda e Jugosllavisë i ngarkon të arrestuarve: „Ata thuheshin se kishin vepruar me porosi të një fuqie të huaj, konkretisht të Republikës Popullore të Shqipërisë, për të shkëputur rajonin e Kosovës nga Jugosllavia“, citon autori i analizës. „Vetëm njëri prej të dënuarve kishte kërkuar ndihmë në ambasadën shqiptare në Beograd dhe kishte raportuar atje për ngjarjet në atdheun e tij, por edhe për këtë vizitë ai u burgos. Një të drejtë të tillë e kanë dhe e realizojnë bashkatdhetarët e tij që jetojnë në vendet perëndimore dhe që janë të organizuar në grupime të ndryshme politike si në Austri dhe punëtorët e emigrantët në Republikën Federale të Gjermanisë. Këto vizita i kanë po thuajse të përhershme (nëpër ambasadat e Shqipërisë në këto vende, por pa pasoja N.K.).“

Propaganda e qeverisë për të justifikuar ndërhyrjen serbe në rajonin e Kosovës ka dështuar. Beogradi shpërndau një hartë (që pretendonte se ishte publikuar në Greqi) që synonte të mbillte frikë për një Shqipëri ekspansioniste apo të madhe. Ajo u dëshmuar e falsifikuar: Pra nuk ishte, siç pretendonte organi i partisë “Vjesnik”, ajo ishte një hartë nga një gazetë shqiptare e publikuar në Tiranë, nga një emigrantë antikomunistë i vjetër me qendrim në SHBA dhe tregon pretendimet për një territor të madh shqiptar që daton nga viti



*Dhuna dhe qëndresa*¹⁵⁷

1913, duke përfshirë edhe pjesë të ish-republikave jugosllave të Maqedonisë dhe Malit të Zi, si dhe pjesë të Greqisë së Veriut.

“Një bombë, të cilën një emigrant shqiptar supozohet ta ketë hedhur në Tiranë në ambasadën jugosllave, u kthye për Beogradin në një bumerang: emigranti, i cili u përmend me emër, është mbi 70 vjeç dhe, si antikomunist, vështirë se do të guxonte të shkonte në Shqipëri. Në fakt, ai nuk e ka lënë SHBA-në prej vitesh.“ Është fjala për Hysen Terpezen.

Shtypi i Jugosllavisë, i cili deri tani kishte akuzuar të dy superfuqitë, si dhe Republikën Federale të Gjermanisë, si autorë të ngritjes popullore të shqiptarëve, „... tani ka gjetur një fajtor të ri: Shërbimin Informativ italian dhe pas tij, NATO-n“. Ja si e dokumentonte këtë: „Dëshmi: Në Romë jetojnë emigrantë shqiptarë, dhe televizionet perëndimore kanë shfaqur një film të fikcionit, që supozon se një Luftë Botërore e Tretë (me radhe – N.K.) mund të shpërthejë pikërisht për shkak të komplikimeve kombëtare në rajonin e veçantë të Kosovës.“ Analisti vazhdon: „Autoritetet shtetërore nuk po mund ta kontrollonin situatën në terren, dhe kriza po bëhej më e thellë.

Prej gjashtë muajsh, pothuajse të gjitha kinematë, teatrot dhe diskotekat janë mbyllur, dhe po ashtu ndeshjet futbolistike luhen pa praninë e publikut, për shkak të dyshimit se grumbullimet apo tubimet e tilla të njerëzve mund të shkaktojnë trazira.“ Një situatë e tillë ishte potenciale për rritjen e pakënaqësisë, sidomos tek të rinjtë, shkruante më tej analisti, duke konstatuar se „... shtypi i partisë njofton se ‘në mure, në shtëpi dhe madje edhe në male shfaqen parolla armiqësore’, pasi Beogradi i ka hequr përjetësisht të drejtën e shqiptarëve të Kosovës për të pasur një republikë të vetën brenda Jugosllavisë, prandaj shfaqet parolla e frikshme: Bashkimi me Shqipërinë, pas shkatërrimit të Jugosllavisë.“ Shtypi i Beogradit vazhdonte me propagandën e tij se komunistët shqiptarë në Kosovë nuk po angazhoheshin në luftimin e këtyre dukurive. Prandaj, thekson autori i analizës se „Në Prizren nuk u gjet asnjë komunist që të paraqiste ose të denonconte një ‘dukuri nacionaliste-irredentiste’, por të gjitha këto dukuri „... i u lënë organeve të ndjekjes“. „Në stacionin e Radio Prishtinës, redaktorët refuzuan të kritikojnë një koleg të tyre; anëtarët e partisë, të ftuar për vetëkritikë, e braktisën mbledhjen e partisë që në pauzë.“

Duke përshtuar gjendjen e rënduar në Kosovë, autori tregon për rezistencën e heshtur të shqiptarëve, ku, siç thotë ai, „Në Minierën e metalve të çmuara në Trepçë, si një nga qendrat më të mëdha ekonomike të rajonit të Kosovës, të gjithë punëtorëve iu premtua që të paraqiteshin rregullisht në vendet e tyre të punës dhe iu ishte premtuar një shpërblim prej 1000 dinarësh (60 marka), sepse që nga trazirat dhe ndërhyrja e trupave policore dhe ushtarake të Federatës, ‘ata punojnë më pak, janë më shpesh të sëmurë’.”

Serbi Petar Kostić, sekretar i partisë në rajonin shqiptar të Kosovës, ankohej: „Situata është konsoliduar shumë më ngadalë sesa e kishim pritur realisht. Më mirë do të ishte që ‘Siguria e Shtetit’ të forcohej me specialistët më të mirë nga e gjithë vendi.“ Një situatë e tillë e tensionuar lëvizte në një drejtim

të paqartë, dhe për këtë arsye; „Të gjithë e dënojnë një veprim të tillë subversiv, por edhe të gjithë heshtin (...), nuk është çudi që parolla armiqësore të shfaqen edhe në shtëpitë e udhëheqësve të organizatave shoqërore-politike, pa mundur të zbulohen ‘autorët’“, përfundon analiza.

Përfundim

Siç u pa nga këto katër analiza të revistës „Der Spiegel“, demonstratat e pranverës së vitit 1981 në Kosovë kishin ngjallur shumë dyshime për atë se cila do të ishte rruga që Jugosllavia do të ndiqte pas vdekjes së Titos. Mendoj se që nga analiza e parë e kësaj reviste, ishte menduar një ndryshim demokratik, duke titulluar analizën e parë „Pa Yllin e Kuq“, që do të thotë se nuk ishte një lëvizje antikomuniste, sepse demonstratat që zhvilloheshin nëpër qytetet e ndryshme të Gjermanisë Perëndimore (të asaj kohe), dominonin kërkesat dhe parullat me përmbajtje ideologjike marksiste si dhe fotografitë e Enver Hoxhës. Në demonstratat në Kosovë kjo nuk kishte ndodhur (në protestën e 11 marsit), prandaj, analistët mendonin se ishte diçka tjetër. Por, duke analizuar këto lëvizje, analistët arsyetonin se mund të kishte edhe paraqitje të tilla, sepse dhuna që u përdor kundër demonstruesve tregonte shenja të një shteti tipik diktatorial, siç janë diktaturat e vendeve të Amerikës Latine, thoshte një komentator i „Süddeutsche Zeitung“ të asaj kohe. Po ashtu, kritikoej Federata dhe posaçërisht Republika e Serbisë, që rrisnin aspiratat e tyre për hegjemoni në Jugosllavi si mbrojtëse e vetme e kësaj federate, pasi që Republika e Sllovenisë dhe Kroacisë pothuajse nuk u interesonin problemet e shqiptarëve dhe serbëve, si dhe raportet e Serbisë me Kosovën. Ky konstatim u përforcua nga një intervistë e dhënë për gazetën „Vjesnik“ të Zagrebit më 31 dhjetor të vitit 1981, nga politikanin e vjetër Bakaric, i cili tha: „... nëse mbahen qëndrime të tilla revanshiste ndaj Kosovës, dhe nuk i jepen asaj të drejtat që i takojnë (...), atëherë lind pyetja: çfarë do të ndodhë?“

(Fund)



*Pamje nga gatishmëria e demonstruesve për realizimin e kërkesave të tyre dhe nga ana tjetër rrethoja ushtarako – policore e regjimit*¹⁹⁵

POLITOLOGU PRANË KREMLINIT: ‘REZULTATI MË I MIRË ËSHTË KAPITULLIMI I EVROPËS DHE UKRAINËS’

Ndërsa presidenti amerikan Donald Trump po i shtyn Rusinë dhe Ukrainën drejt një armëpushimi, zëra me ndikim në Moskë po i bëjnë thirrje autoriteteve ruse të ndjekin një linjë më të ashpër. Presidenti rus Vladimir Putin ka sugjeruar se është i gatshëm për një ndalim të luftimeve, por thotë se “ka nuanca” – të cilat i shpalosi gjatë bisedimeve me të dërguarin amerikan Steve Witkoff në Kremlin, të enjten.

Që nga fillimi i kësaj lufte, Putin ka kërkuar “çmilitarizimin” e Ukrainës, një kërkesë që është e papranueshme për Kievin dhe aleatët e tij. Steve Rosenberg, redaktori i BBC për Rusinë, ka biseduar me Sergey Karaganov, politolog dhe ish-këshilltar i Kremlinit. “Evropa është qendra e të gjitha problemeve që ka pasur bota”, thotë ai. “Dy luftëra botërore, ideologjitë më të këqija. Evropa duhet të hiqet mënjanë për momentin, të mos jetë më qendra e politikës botërore. Dhe për këtë, ne duhet të mposhtim Ukrainën. Nuk po luftojmë kundër ukrainasve, po luftojmë kundër Evropës.”

Por Evropa tani po përpiket të forcojë mbrojtjen e saj. BE-ja thotë se kjo është një pikë kthese për Evropën. Presidenti Macron ka deklaruar se Rusia është një kërcënim për të gjithë kontinentin. Evropa duket se ka frikë, se Rusia nuk do të ndalet në Ukrainë, por do të vazhdojë më tej. A ka të drejtë Evropa të frikësohet?

“Rusia nuk ka nevojë për Evropën. Pse duhet ta marrim këtë grumbull mbeturinash? Kjo mbeturinë morale në të cilën është kthyer Evropa. Nuk na duhet. Arsyeja e vetme pse filluam të luftonim është sepse kemi parashikuar dhe kemi paralajmëruar për 27 vjet për zgjerimin e NATO-s dhe se ajo nuk duhet të afrohej pranë kufijve rusë.”

Si do të përgjigjet Rusia? Si mendoni se duhet të reagojë Rusia ndaj asaj që po ndodh në Evropë tani?

“Duhet të mposhtim dhe të shkatërrojmë atë që unë e quaj ‘shtylla morale’ e elitave evropiane, ashtu siç kemi bërë dy herë tashmë në historinë e afërt.”

Çfarë do të thotë “shkatërrimi i shtyllës morale të Evropës” sot?

“Do të thotë se ne duhet t’u tregojmë atyre se agresioni i tyre është i dëmshëm për ta,



veçanërisht për elitat.”

Keni folur kohët e fundit për nevojën e një përshkallëzimi bërthamor ose të ngjites së shkallëve të përshkallëzimit bërthamor. Deri ku do të ishit të gatshëm të shkonit në këtë drejtim?

“Nëse është e nevojshme, deri në fund. Por shpresoj që tashmë ta kemi kaluar atë pikë, sepse amerikanët, pasi ne filluam të ngjiteshim në këtë shkallë, filluan të tërhiqeshin.”

A e përjashtoni, për shembull, një sulm bërthamor parandalues ndaj Evropës?

“Pse? Jo tani. Dua të them, në parim, kam argumentuar se nëse gjërat vazhdojnë kështu, ne duhet t’i ndëshkojmë evropianët.”

Me një sulm parandalues?

“Po, një sulm parandalues, dhe ne do ta bënim këtë pa pasoja. Por siç kam thënë publikisht dhe jo publikisht, është një zgjedhje e tmerrshme morale, nuk duhet ta bëjmë.

Megjithatë, nëse shtyhem i në cep, mund ta bëjmë këtë, pa pasoja. Amerikanët nuk do të hakmerreshin kurrë.”

Disa do të thoshin se edhe sugjerimi i një sulmi bërthamor parandalues ndaj Evropës është më e pakta i papërgjegjshëm, dhe më e shumta, një çmenduri.

“Më lejoni t’ju kujtoj se politika zyrtare e NATO-s parashikon një goditje për së pari. NATO është ndërtuar mbi këtë supozim, është pjesë e doktrinës së saj. Pra, njerëz si unë thjesht po përsërisin atë që NATO ka bërë për dekada.”

Sa i përket NATO-s, po bëhet shumë diskutim mbi dobësinë e aleancës dhe përkushtimin e Amerikës ndaj saj. A e bën kjo më të mundshme që Rusia të dërgojë trupa në një vend anëtar të NATO-s, për shembull në shtetet baltike?

“Sigurisht, nëse një vend i NATO-s kërcënon drejtpërdrejt sigurinë tonë, kjo mund të ndodhë. Por pse do ta bënim?

Mënyra më e mirë, dhe këtë ua kam thënë fqinjëve tanë, për të garantuar sigurinë evropiane është të kesh marrëdhënie të mira me Rusinë. Marrëdhënie miqësore, akoma më mirë. Pse duhet të shkojmë në këtë varrezë që është Evropa? Kemi mjaft burime, më shumë se tokë të mjaftueshme për t’u zhvilluar.”

Dua të kuptoj se cili është objektivi i Rosisë këtu. Synimi është të arrihet një marrëveshje për Ukrainën, apo të sigurohet kapitullimi i plotë i Kievit?

“Së pari, rezultati më i mirë i mundshëm është kapitullimi i plotë i Ukrainës dhe Evropës. Ne duhet ta përfundojmë këtë luftë në një mënyrë ose në një tjetër, dhe shpresoj që ajo që dikur ishte Ukraina të çmilitarizohet dhe neutralizohet plotësisht dhe të jetojë në paqe. Nuk mund të lejojmë që të përdoret si një majë shtize kundër Rosisë. Nëse jo, lufta do të vazhdojë.”

A nuk ishte lufta e panevojshme që në fillim? Nuk kishte rrezik real që Perëndimi të sulmonte Rusinë apo që Ukraina të pushtonte Rusinë, apo jo?

“Ne ju kemi thënë ju dhe liderëve tuaj që nga viti 1997 se nëse vazhdoni zgjerimin e NATO-s—që është një agresion ushtarak dhe politik—lufta do të shpërthente. Dhe ja, ndodhi!”

Në Perëndim ka shumë kritika ndaj Rosisë, duke thënë se nuk ka asnjë shenjë kompromisi apo lëshimi nga Moska. Cila është përgjigja e Rosisë për këtë?

“Pse duhet të bëjmë lëshime? Kemi qenë të sulmuar për 27 vjet, po mbrohemi, dhe jemi fitimtarë.”

Por ishte Rusia ajo që nisi pushtimin e plotë të Ukrainës tre vjet më parë.

“Më falni, por ne kemi 27 apo 28 vjet që po mbrohemi nga agresioni ushtarak dhe politik i NATO-s.” / BBC – Bota.al



Veton ZYMBERI, redaktor i sportit

Të dielën mbahet edicioni i katërt Vrapimi i Marsit ‘Izbica 147’

PRISHTINË, 17 MARS - Dy ditë pas ployës në Krushë të Madhe, forcat serbe, në vazhden e ushtrimit të gjenocidit në Kosovë, kryen më 28 mars 1999 në Izbicë të Skenderajt aktin tjetër gjenocidar, ku i vranë dhe masakruan 147 shqiptarë të

të gjitha moshave. Në nderim të këtyre viktimave dhe të gjithë dëshmorëve të komunës së Skenderajt, më 23 mars 2025 (e diel), mbahet në Izbicë edicioni i katërt i garës sportive Vrapimi i Marsit “Izbica 147”. Gara, po ashtu, ka për qëllim ta

bashkojë komunitetin e vrapuesve nga të gjithë trojet shqiptare, ta promovojë vrapimin malor dhe t’i japë shtytje të mëtutjeshme këtij lloj aktiviteti sportiv. Edicioni i katërt Vrapimi i Marsit “Izbica 147” do të zhvillohet në tri distanca: 2km, 10km

dhe 21km. Në distancën 2km do të vrapojnë grupmoshat e reja. Ju ftojmë të bëheni pjesë e këtij eventi përkujtimor, duke nderuar vlerat sublime dhe historinë tonë, thuhet në një publikim të bërë nga organizatori i këtij vrapimi. Të interesuarit mund të



regjistrohen duke hyrë në faqen: www.kosovopass.com.

Foda: Shpresoj të fitojmë në shtëpi ndaj Islandës

EPOKA E RE

Veton ZYMBERI

PRISHTINË, 17 MARS - Përzgjedhësi i Kosovës në futboll, Franco Foda, në konferencë për medie para dy ndeshjeve që “dardanët” i zhvillojnë në Ligën e Kombeve kundër Islandës në “play-off” të Ligës së Kombeve, ka shprehur optimizëm se do të arrijë fitore. Trajneri gjerman i Kosovës ka thënë se e ka studiuar lojën e kundërshtarit, por shanset janë 50 me 50. “I kemi disa mungesa, tani duhet të gjejmë zgjedhje të reja. E kemi studiuar Islandën, është intensive, agresive, ka lojtarë të mirë. Shpresoj shumë që të fitojmë në shtëpi. Duhet të bëjmë intensitet të shtuar në lojë dhe ta zbatojmë lojën tonë. Islanda është kundërshtarë e fuqishme, shanset janë 50 me

50. Nëse fitojmë në shtëpi, do ta kemi një përparësi. Është e rëndësishme të kemi paraqitje të mirë në fushë, të paraqitemi si ekip i përbashkët, të tregojmë mendësi të fortë, ta përkrahim njëri-tjetrin në fushë dhe kështu mund të arrihet deri te fitorja”, ka thënë Foda.

Më pas trajneri i Kosovës foli edhe për futbollistin Etnik Brruti, i cili ditë më parë vendosi të largohet nga Kosova U21 dhe t’i bashkohet Kombëtares së Shqipërisë. Foda e ka vlerësuar Brrutin si një lojtar me perspektivë të madhe. “E kemi shikuar Brrutin në kampin stërvitor në janar, gjithashtu e kemi përcjell edhe te Malisheva. Kam biseduar personalisht me Brrutin dhe i kam dhënë sqarimet dhe konsultat e mia. Ai ka qenë një lojtar me



perspektivë, kapiten i grupmoshave, por për mua me rëndësi është që një lojtar të luajë me zemër për Kosovën. Ai ka vendosur të luajë për Shqipërinë dhe është vendimi i tij. Duhet ta pranojmë”, ka deklaruar Foda, i cili bëri me pas

me dije se Qëndrim Zyba u ftua pas lëndimit të Fisnik Asllanit dhe Florent Hadërgjonajt. Për lojtarin e shumëpërforcuar, Meriton Korenica, Foda ka thënë se nëse vazhdon me formën e njëjtë, atëherë në qershor do të jetë pjesë e Kosovës.

“Fatkeqësisht nuk mund t’i ftojme 30 lojtarë, kemi menduar t’i ftojme vetëm 25 lojtarë, këta na kanë bindur se janë të duhurit. Në qershor i kemi ndeshjet e tjera. Nëse lojtari në fjalë vazhdon me formë të tillë, atëherë mund të ketë ftesë edhe për të”, ka shtuar ai.

Kapiteni i Kosovës, Amir Rrahmani, është lënduar të dielën në ndeshjen që Napoli e zhvilloi ndaj Venezas por, sipas përzgjedhësit Fodam do të jetë pjesë e Kosovës në këto dy ndeshje. “Rrahmani ka probleme të lehta muskulore, por ai do të jetë i pranishëm në grumbullim”, ka thënë shkurtimisht Foda. Ndeshja e parë në mes të Kosovës dhe Islandës zhvillohet më 20 mars në stadiumin “Fadil Vokrri” në Prishtinë.

‘Ylli i javës’, Adetunji: Ne e dinin sa e rëndësishme është kjo ndeshje



SUHAREKË, 17 MARS - Federata e Futbollit e Kosovës dhe sponsori i Superligës, Albi Mall, vazhdojnë ta japin çmimin “Ylli i Javës”. Ky çmim për javën e 25-të në Albi Mall Superligë i është dhënë futbollistit të FC Ballkani, Adetunji Sunday Damilare. Vlerësimi i më të mirit të javës është bërë nga Komisioni i Veteranëve të Futbollit, në përbërje të Agim Maliqit, Enver Prapashticës dhe Isuf Llumnicës. Ky komision vendosi që çmimi “Ylli i Javës” për xhiron e njëzet e pestë t’i

jepet sulmuesit Adetunji, i cili me dy supergolat e tij i dha tre pikë skuadrës së tij kundër FC Ferizaj, e cila përfundoi me rezultat 2:1. Pasi mori këtë çmim, Adetunji u shpreh i lumtur që u vlerësua më i miri i javës: “Ne e dinin sa e rëndësishme është kjo ndeshje. Duke parë disa nga ndeshjet e fundit, kemi luftuar shumë për të arritur deri këtu. Kështu që, duke hyrë në këtë ndeshje, e dinim sa vlerë kishte. Ishte një përpjekje kolektive dhe mënyra se si fituam ishte e jashtëzakonshme. Po, është një

ndjenjë fantastike për mua, por meritat u shkojnë shokëve të ekipit, sepse pa ta nuk do të ishte e mundur”. “Kështu që këtë fitore ua dedikoj të gjithëve. Ishte një përpjekje e përbashkët për ne. Nuk isha vetëm unë. Unë thjesht dhashë kontributin tim. Po, në këtë kampionat, e pranoj që nuk luajtëm mirë, por ishim pa fat dhe në futboll ndodh edhe kjo. Nuk është se luajtëm keq, por ndonjëherë thjesht nuk të ndihmon fati”, ka deklaruar Adetunji për faqen zyrtare të FFK-së.

Nesbitt, ylli i Yllit

SUHAREKË, 17 MARS - Jalen Nesbitt po kalon në formë të jashtëzakonshme në ndeshjet e fundit. Pasi shkëlqeu ndaj kampiones, Trepçës, shkëlqeu edhe ndaj Sigal Prishtinës, duke ndihmuar skuadrën e tij, Golden Eagle Ylli, me një fitore shumë të rëndësishme

në kryeqytet. Ai ndeshjen ndaj prishtinasve e mbylli me 18 pikë, 15 kërcime e pesë asistime. Nesbitt kishte indeksin 36, apo më të lartën e javës së 24-t, duke u shpallur për herë të dytë radhazi MVP. Paraqitje shumë të mirë tregoi edhe Lis Shoshi me 15 pikë,

gjashtë kërcime dhe dy asistime. Bashkimi fitoi bindshëm derbin e qytetit ndaj Proton Cable Prizrenit, ku Dirk Williams e mbylli ndeshje me 22 pikë, pesë kërcime dhe tri asistime. Fitoren e tretë radhazi e regjistroi Peja, duke mundur Borën, ku Benas Griciunas e

përfundoi ndeshjen me 13 pikë, 12 kërcime dhe dy asistime. Fitore të vështirë regjistroi edhe Trepça, duke përmbysur Vëllaznimin, e te mitrovicasit u dallua basketbollisti me përvojë Drilon Hajrizi me 14 pikë, nëntë kërcime dhe tri asistime.



Verstappeni: Vendi i dytë në Australi ishte maksimumi, McLaren i është ende më i shpejtë

MELBOURNE, 17 MARS - Vendi i dytë në garën e Australisë vlen si një fitore për Max Verstappenin, duke marrë parasysh vështirësitë që ka përjetuar Red Bull i së fundi. Madje në fund ta garës ai u përpoq të parakalojë Lando Norris, por pa sukses.

“Fillimi i sezonit ishte argëtues. U përpoqa të qëndroja me McLarenin, por si pothuajse të gjitha skuadrat e tjera, filluam të luftonim shumë me degradimin dhe mbinxhëm shumë gomat. Kështu që McLaren i u shkëput”, ka

thënë Verstappen. “Unë dhashë gjithçka, u përpoqa të fokusohesha në garën time dhe moti na ndihmoi disi. Kur filloi shiu u përpoqëm të bënim diçka ndryshe, por ishte e pamundur ta pilotojë makinën me gomat për pistë të thatë”, ka shtuar kampioni

i botës në Formula 1. Më tej, Verstappen i ka deklaruar: “Nuk ka asnjë keqardhje për zgjedhjen e gomave. Jemi 18 pikë më shumë se vitin e kaluar, pasi vjet u tërhoqa nga gara në Melburn. Gjithsesi, McLaren i është ende më i shpejtë, por ne



duhet të përpiqemi të qëndrojmë afër”.

Hoxha: Ndeshje shumë e vështirë ndaj Anglisë, presim rezultat pozitiv

TIRANË, 17 MARS - Përgatitjet për fushatën eliminatore të Botërorit 2026, të cilat e ngrënë siparin më 21 mars për kuqezinj të tanë, pikërisht në mitikun “Wembley”, ndaj Anglisë së madhe, kanë nisur sot. Natyrisht, në seancën e parë nuk kanë qenë të gjithë kuqezinj të ftuar nga trajneri Sylvinho për dy kualifikueset e radhës, por grupi pritët të plotësohet deri në mbrëmje. Në konferencë për shtyp kanë dalë dy lojtarë të rinj, Arbër Hoxha dhe Julian Shehu. “Ndeshja e parë me Anglinë është e vështirë, duke marrë parasysh që kundërshtari ka lojtarë të klasës botërore. Ne do të shkojmë për ta dhënë maksimumin, i dimë cilësitë dhe kualitetet tona. Shpresojmë të marrim një rezultat pozitiv. Unë do të bëj më të mirën, sa minuta të kem në dispozicion”, ka thënë Hoxha, i cili e ka quajtur të suksesshëm vitin në kombëtaren kuqezi. “Besoj që ka qenë një vit shumë i mirë, sepse arritëm kualifikimin në Evropian. Do të bëjmë më të mirën gjithmonë dhe shpresoj që të kualifikohemi në Botëror”, ka shtuar ai. Ndërsa në kombëtare ka thënë se konkurrenca gjithmonë e bën



më të fortë dhe se do të japë maksimumin për të marrë sa më shumë minuta. I pyetur se si po shkon sezoni me klubin, Hoxha është përgjigjur: “Si çdo futbollist, ka ulje dhe ngritje, edhe unë jam një prej tyre. Kohët e fundit nuk kam pasur shumë ritëm në ndeshje. Ato minuta që kam pasur, jam munduar t’i shfrytëzoj në maksimum. Shpresoj që sa më shpejt ta arrij formën dhe të kem sa më shumë minuta në dispozicion”. Hoxha

ka folur për pritshmëritë në ndeshjen ndaj Anglisë, duke besuar se presin rezultat pozitiv ndaj Anglisë. “Atë e vendos trajneri. Po presim edhe lojtarët e tjerë që të na bashkohen. Kemi katër ditë në dispozicion për t’u përgatitur taktikisht. Duam ta përgatisim ndeshjen sa më mirë. Po, normalisht që besojmë, kjo nuk diskutohet fare. Unë besoj se grupi ka kualitet për të arritur një rezultat pozitiv”, ka shtuar Hoxha.

Oklahoma triumfon në fushën e Milwaukeees, zhgënjën Clevelandin, fitojnë lakersat e clippersat

OHIO, 17 MARS - Skuadra e Clevelandit u mund me rezultat 108-103 nga Orlando, por e ruan kreun e renditjes në Konferencën e Lindjes. Bancho me 24 pikë e 11 rebounde ishte lider për miqtë, duke i bërë të pavlefshme 23 pikët e Donovan për Cavaliersin. Në Perëndim, ekipi i Oklahomës fitoi me shifrat 121-105 në fushën e Milwaukeees dhe ruan kryesimin, në një ndeshje të dominuar nga miqtë. Shai me 31 pikë e Hartenstein me 24 u dalluan, duke e bërë të pavlefshme “triple double” të Antetokounmpo. Rikthehet te fitorja ekipi i lakersave, që mundi me rezultat 107-96



Phoenixin, ndeshje ku u dalluan Doniqi me 33 pikë e Reaves me 28 pikë. Fitoi edhe skuadra e Philadelphia, 130-125 në fushën e Dallasit, takim ku dallimin e bëri Grimes me 28 pikë. Skuadra e clippersve triumfoi me rezultat 123-88 ndaj

Charlottes, ndeshje pa histori, ku shkëlqeu James Hardeni me 31 pikë e 10 rebounde. Sukses në sekondat e fundit për Portlandin, që mundi me rezultat 105-102 Toronton (Simons me 22 pikë më i miri).

REZULTATET	
Cleveland - Orlando	103-108
Dallas - Philadelphia	125-130
Lakers - Phoenix	107-96
Portland - Toronto	105-102
Brooklyn - Atlanta	122-114
Minnesota - Utah Jazz	128-102
Clippers - Charlotte	123-88
Milwaukee - Oklahoma	105-121

SHKURT

Rrahmani në formacionin e javës në Serinë A

Amir Rrahmani është përfshirë në formacionin e javës në Serinë A. Ylli “dardan” ishte merituar që Napoli e mori një pikë ndaj Venezias në xhiron e 29 të kampionatit italian. Ndeshja përfundoi baras, 0-0, ndërsa faqja e specializuar për vlerësimin e lojtarëve, WhoScored, e përfshiu atë në ekipin e javës në Itali, ndërsa e vlerësoi me notën 7.80. Rrahmani luajti 77 minuta dhe u zëvendësua me Juan Jesus. Formacioni: Radu, Acerbi, Mancini, Rrahmani, Orsolini, Ferguson, Duda, Miranda, Pulisic, Martinez, Ndoje.

Simeone: Barcelona pati fat, nuk mund t’u kërkoj më shumë lojtarëve të mi

Athletico Madridi pësoi humbje nga Barcelona (2-4), por trajneri Diego Simeone ishte i kënaqur me përkushtimin dhe punën e lojtarëve të tij. Ai theksoi se skuadra e tij “reagoi mirë dhe konkurroi ashtu siç e kishim imagjinuar”, por pranoi se katalanasit patën atë dozën e fatit që duhet në rastin e devijimit të Lamine Yamal. “Barcelona është një skuadër e madhe. Tani duhet të vazhdojmë të punojmë. Nuk mund t’ju kërkoj më shumë lojtarëve të mi, sepse kanë dhënë gjithçka”. Ai gjithashtu beson se ekipi i tij vazhdon të jetë në garë: “Skuadra po konkurren, kemi nevojë për fitore. Kemi një mundësi për të aritur në finalen e Kupës dhe do të luftojmë deri në fund për kampionatin. Dy kryesuesit ende duhet të luajnë mes tyre”.

Unitedi, gati 70 milionë euro për Raphinhan

Manchester Unitedi po synon të bëjë revolucion në ekip për sezonin e ardhshëm pas kërkesave të trajnerit Ruben Amorim. Mësohet se njëri prej lojtarëve që Amorim e do nën urdhrat e tij është braziliani i Barcelonës, Raphinha, që këtë sezon po kalon nëpër një formë fantastike. Thuhet se Unitedi i ka bërë ofertë Barcelonës për Raphinhan duke i ofruar 70 milionë euro për kartonin e tij. Mbetet të shihet nëse Barcelona do ta pranojë ofertën e Manchester Unitedit për 28-vjeçarin që ka kontratë deri në vitin 2027 dhe këtë sezon ka shënuar 27 gola dhe ka bërë 21 asistime në të gjitha garat.

Shevchenko: E ardhmja e futbollit në Ukrainë varet nga paqja

“Është një vend i tërë që punon për paqen. Ne të gjithë shpresojmë për paqen. Dua të ‘ialënderoj gjithmonë djemtë dhe vajzat tona që mbrojnë kufijtë e vendit. Që po e mbajnë atë gjallë”. Kështu është shprehur ish-fituesi i “Topit të Artë”, Andriy Shevchenko, president i Federatës së Futbollit të Ukrainës, në një intervistë për “Giornale”. “Sfida më e madhe është të sigurohemi që ndeshjet të mos ndalen, pavarësisht nga kjo luftë e tmerrshme e kërkuar nga Rusia, e cila pushtoi Ukrainën, domethënë një shtet sovran. Dhe a e dini se një ekip nga Kiev, Lokomotiv, do të marrë pjesë në Turneun Manlio Selis në Sardenjë në fund të majit, i cili është një nga më të rëndësishmit në Evropë në nivel të të rinjve? Djemtë do ta kujtojnë atë udhëtim gjithë jetën”, ka shtuar ai. Më pas Shevchenk ka shtuar: “E ardhmja e futbollit në Ukrainë varet edhe nga paqja”.

Flick: Kjo Barcelonë është fantastike

Barcelona e mposhti me përmbyse Atletico Madridin (2-4). Trajneri gjerman Hansi Flick është shprehur i kënaqur me fitoren e arritur. “Mendoj se sonte e treguam mentalitetin tonë pas disavantazhit me dy gola. Ka qenë e

pabesueshme se si ekipi ynë e përmbysi rezultatin. Jam shumë i lumtur për ekipin, klubin dhe tifozët. Ndeshje e pabesueshme, një çmenduri, me 20 minutat e fundit fantastike. Në pjesën e parë, gjithashtu, luajtëm mirë. Në pjesën

e dytë, pas dy golave të pësuar, treguam mentalitetin se nuk dorëzohemi kurrë. Pas golit të parë tonit u hap një dritë shprese”, ka thënë Flick. Një nga emrat e ndeshjes ishte Ferran Torres, autori i dy golave pas

ardhjes nga stoli në pjesën e dytë: “Kjo Barcelonë është fantastike. Kemi formacionin startues, por lojtarët që erdhën nga bankina bëjnë shumë mirë. Më e rëndësishmja është se të gjithë lojtarët stërviten shumë mirë dhe

shkëlqejnë kur na nevojitet ndihma e tyre”. Trajneri gjerman në fund ka thënë se Barcelona do ta bëjmë maksimumin dhe do të luftojmë deri në fund për ta fituar kampionatin, ani pse rruga është shumë e gjatë.



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo

Qeveria – Vlada-Government
MINISTRIA E ARSIMIT, SHKENCËS, TEKNOLOGJISË DHE INOVACIONIT
AGJENCIA PËR ARSIM DHE AFTËSIM PROFESIONAL DHE ARSIM PËR TË RRITUR
AGENCIA ZA PROFESIONALNO OBRAZOVANJE I OSPOSOBLAVANJE I OBRAZOVANJE ZA ODRASLE
AGENCY FOR VOCATIONAL EDUCATION AND TRAINING AND ADULT EDUCATION

Nr: 551/1
Dt: 17.03.2025

Në bazë të nenit 8, paragrafi 1 dhe 2 të Ligjit të Punës Nr. 03/L-212, nenit 35 të Ligjit Nr. 04/L-032 për Arsimin Para universitar në Republikën e Kosovës, nenit 13 dhe 34 të Ligjit për Arsimin dhe Aftësimin Profesional 04/L-138, neni 81 i Ligjit për Zyrtar Publik Nr. 08/L-197, Udhëzimit Administrativ 14/2014, Udhëzimit Administrativ Nr. 05/2015, Udhëzimit Administrativ Nr. 05/2012, Rregullores (Qrk) Nr.19/2024 për Procedurat e Përzgjedhjes dhe Emërimit të Drejtorëve dhe Zëvendës drejtorëve, Mësimdhënësve, Bashkëpunëtorëve Profesional, Asistentëve, Instruktorëve dhe Sekretarëve në Institucionet Publike Edukativo-Arsimore dhe Aftësuese (IEAA) të Arsimit Parauniversitar, Agjencioni për Arsim dhe Aftësim Profesional dhe Arsim për të Rritur shpall:

KONKURS PËR PLOTËSIMIN E VENDEVE TË PUNËS

Niveli	Institucioni/ Shkolla	Vendi	Pozita:	Vend i lirë/ Zëvendësim	Numri i pozitive	Koeficienti i pagës
SHML	Qendra e Kompetencës Skenderaj	Skenderaj	Mësimdhënës i elektroteknikës për lëndët ne profilin Instalues Elektrik	Zëvendësim	1	5.8

I. Kushtet e përgjithshme dhe të veçanta për këtë vend pune

- Të jetë shtetas i Republikës së Kosovës;
- Të ketë zotësi të plotë veprimi, sipas legjislacionit në fuqi;
- Të zotërojnë të paktën njërën nga gjuhët zyrtare, në pajtim me Ligjin për Gjuhët;
- Të jetë e/i aftë për të kryer detyrën përkatëse;
- Të mos jetë e/i dënuar për kryerjen e veprës penale me dashje;
- Të mos ketë në fuqi masë disiplinore për shkelje të rëndë në institucion publik (vlen për të punësuarit në institucione publike). Kandidatët që nuk janë të punësuar në institucione publike duhet të dërgojnë një vetëdeklaratë me shkrim të nënshkruar se nuk kanë masë disiplinore për shkelje të rëndë në institucion publik.

II. Në momentin e aplikimit, kandidatët duhet të dorëzojnë këto dokumente:

- Formulari i aplikimit (merret në Qendrën e Kompetencës për të cilën është shpallur konkursi)
- Rezymeja personale (CV)
- Dokumenti personal (kopje të letërnjoftimit ose pasaportës)
- Diplomat e kualifikimit (ose certifikatat të noterizuara)
- Kandidatët që kanë diplomuar jashtë Kosovës, **duhet të kenë diplomat e nostrifikuara në MASHTI**
- Certifikatat e trajnimeve të akredituara nga MASHT
- Dëshmi të përvojës së punës ne arsim (kontratat e punës ose vërtetim)
- Certifikatën shëndetësore të lëshuar nga një institucion i licencuar shëndetësor me të cilën dëshmohet gjendja e tij/saj shëndetësore;
- Licencën e mësimdhënësit/es, sipas procedurave për lëshimin e licencës për mësimdhënës/e, nëse një gjë e tillë nuk është shfuqizuar përmes një akti nënligjor të MASHTI për rregullimin e provimit shtetëror të mësimdhënësit;
- Përgjashtimisht për kandidatët që konkurrojnë për pozitën e mësimdhënësit/es fillestar/e, nuk kërkohet licenca;
- Dëshminë se nuk është i dënuar për kryerjen e veprës penale me dashje.
- Kandidatët që kanë përvojë pune dorëzojnë edhe portfolio profesionale me përmbledhjen e punës së tyre (Udhëzimi për përgatitjen e portofolies Profesionale merret në Qendrën e Kompetencës përkatëse me rastin e aplikimit)

III. Kushtet dhe kriteret e përzgjedhjes së kandidatëve të stafit mësimor

Përzgjedhja e kandidatëve do të bëhet në bazë të kriterëve të përcaktuara me akte juridike që e rregullojnë fushën e arsimit parauniversitar (**Ligji Nr. 04/L-032, Ligji Nr. 04/L-138**) dhe në përputhje me Udhëzimin Administrativ përkatës të **MASHTI-it: UA Nr. 05/2015**, si dhe procedurave të përcaktuara me kornizën ligjore për rregullimin e marrëdhënies së punës në sektorin publik.

Kriteret e kualifikimit për Mësimdhënës/e për profilin e Ndërtimtarisë

- Msc. i elektroteknikës / elektroenergjetikë
- Inxh. i dipl. i elektroteknikës/ elektroenergjetikë

IV. Detyrat dhe Përgjegjësitë për mësimdhënës;

- Mësimdhënësi është i obliguar ta realizojë planprogramin mësimor për vendin përkatës të punës duke u bazuar në Ligjin mbi Arsimin Para universitar në Republikën e Kosovës dhe në aktet e tjera nënligjore, të cilat i rregullojnë fushat përkatëse relevante për vendin e tij/ saj të punës.
- Të zbatojë detyrat e punës duke siguruar cilësinë dhe kompetencën profesionale në procesin e mësimdhënies.
- Të zbatojë metodologjitë e reja të mësimdhënies dhe të vlerësimit në përputhje me udhëzimet e planprogramit të ri.
- Të tregojë respekt dhe të sillet me drejtësi e pa dallime me njerëzit me të cilët punon.

- Të respektojë autoritetin e drejtpërdrejtë të zyrtarit të cilit i raporton dhe t’i kryejë detyrat që mund t’ua caktoj ai/ajo. Detyrat e punës duhet të jenë në harmoni me legjislacionin ne fuqi.
- Nuk mund të kërkoj apo të pranoj udhëzime lidhur me kryerjen e detyrave të punës nga asnjë organ tjetër përveç Organit Drejtues të Qendrën Kompetencës dhe AAAPARr-së.
- Nuk lejohet shfrytëzimi i pozitës për përfitime private në dobi të ndonjë pale të tretë.
- Diagnostifikon kushtet për mësim dhe proceseve mësimore të nxënësve përmes proceseve të përshtatshme dhe reagon në mënyrën e duhur ndaj tyre, duke filluar masa të ndryshme mbështetëse individuale ndaj nxënësve.
- Puna monitorohet dhe vlerësohet mbi bazën e rezultateve të arritura të nxënësve sipas procedurave profesionale nga ana e ekspertëve përkatës.

V. Vlerësimi i kandidatëve

- Vlerësimi i njohurive, aftësive dhe cilësive profesionale të kandidatëve bëhet përmes:
- Testit me shkrim, i cili përbënë 50% të vlerësimit të përgjithshëm dhe ka në total 100 pikë,
- Intervista me gojë, pjesë e së cilës është edhe vlerësimi i portfolios, përbënë 50% të vlerësimit të përgjithshëm.
- Pikët nga testi me shkrim dhe intervista me gojë mbledhen në shumën e përgjithshme dhe kandidatët me më shumë pikë do të përzgjedhjen në pozitat e lartpërmendura;
- Lista e ngushtë e aplikantëve që ftohen për test me shkrim dhe intervistë me gojë, si dhe orari i intervistave do të njoftohen me e-mail dhe përmes telefonit.
- Rezultatet përfundimtare të vlerësimit do tu dërgohen kandidatëve me e-mail dhe do të shpallen në <https://konkursi.rks-gov.net/>.

VI. Afati dhe mënyra e aplikimit

- Konkursi mbetet i hapur 30 ditë nga dita e shpalljes nga data 18.03.2025 deri me 16.04.2025.
- Aplikacioni merret dhe dorëzohet në Shkollën përkatëse;
- Dokumentet e pakompletuara si dhe ato pas afatit, nuk merren në shqyrtim;
- Dokumentet e dorëzuara nuk kthehen dhe duhet të jenë kopje, përveç diplomave të noterizuara;
- Si informata të sakta dhe të vërteta, konsiderohen vetëm informatat që janë të dëshmuara me dokumente përkatëse (jo vetëm të deklaruara në aplikacion);
- Anëtarët e komuniteteve jo shumicë dhe personat me afëtesi të kufizuar inkurajohen të aplikojnë në pozitat e shpallura në përputhje me kualifikimet përkatëse.

Vërejtje: Të gjitha aplikacionet e pakompletuara, mosplotësimet e sakta dhe të qarta të formularit të aplikimit dhe ato që dorëzohen jashtë afatit zyrtar të përcaktuar në këtë konkurs nuk do të shqyrtohen.

NJOFTIM

Njoftojmë të gjithë klientët se Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar “Pave Group” SH.P.K. me seli në Viti, ka marrë vendim të shuajë biznesin me nrb. 812091908 dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditore - Debitorë në këtë korporatë që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

OBAVESTENJE

Obavestavanje se svi klienti da drustvo sa “Pave Group” D.O.O. Viti, donelo odluku o prestani rada sa nrb. 812091908 ujedno imenovao Likvidatora o sprovođenju postupka likfidacije. Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze i potrazivanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanja o novine.

ANNOUNCEMENT

We inform al customers that the limited liability “Pave Group” L.L.C. with headquarters Viti, has come to the decision to quit its business: 812091908 the company has appointet a liquidator wsho is going to oversee the liquidator process. All clients who have the mortgager – mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement- publication.



SHPALLJE E VENDIT TË LIRË TË PUNËS

Titulli i vendit të punës: Administratore i/e Lartë i Bazave të të Dhënave
Grada: P05
Kohëzgjatja e punësimit: me afat të pacaktuar
Departamenti: Teknologjisë së Informacionit dhe Sigurisë
Divizioni: Për Menaxhimin e Databazave dhe Aplikacioneve
I raporton: Udhëheqësit të Divizionit për Menaxhimin e Databazave dhe Aplikacioneve

Detyrat dhe Përgjegjësitë Kryesore:

- Administron bazat e të dhënave për aplikacionet që zhvillohen në Departamentin e Teknologjisë Informative;
- Planifikon krijimin dhe mirëmbajtjen e bazave të të dhënave. Punon ngushtë me administratorët e sistemeve gjatë instalimit të aplikacioneve të cilat lidhen me bazat e të dhënave;
- Instalon versione të reja të databazave dhe veglave të saj, si dhe veglave të tjera të nevojshme për qasje në baza të të dhënave;
- Vlerëson versionet e databazave, veglave ndihmëse, në mënyrë që të sigurojë se baza e të dhënave punon sipas standardeve. Në bashkëpunim me administratorët e tjerë dhe zhvilluesit e aplikacioneve, planifikon përditësime me ndikim minimal në punën e sistemeve;
- Administruesi i bazave të të dhënave është edhe pikë kontakti me përkrahjen teknike të Oracle dhe Microsoft, si dhe me kompanitë e tjera që kanë zhvilluar sisteme për BQK-në;
- Shkrimi i query-ve të avancuara për analizën e të dhënave dhe përpunimin e tyre sipas nevojave të biznesit.
- Rregullon problemet e ndryshme në bazat e të dhënave, aplikacioneve, komunikimin në mes tyre dhe veglave të tjera të cilat raportohen nga shfrytëzuesit;
- Monitoron dhe në rast të problemeve, rregullon problemet me komunikim në mes të databazave dhe aplikacioneve të ndryshme;
- Konfiguron bazat e të të dhënave për “*high availability*”;
- Planifikon, implementon dhe teston në mënyrë të vazhdueshme procedurat për backup dhe restore të bazave së të dhënave;
- Menaxhimi i të drejtave të shfrytëzuesve dhe politikave të sigurisë për të siguruar qasje të sigurt.
- Mbështetja teknike dhe diagnostikimi i problemeve të bazës së të dhënave për të siguruar funksionimin pa ndërprerje.
- Kryen proceset e EOD (End of Day) pas mbylljes se orarit;
- Kryen edhe detyra të tjera të caktuara nga udhëheqës-i/ja.

Edukimi:

- Diplomë universitare në fushën e shkencave kompjuterike, elektroteknike apo matematikës, ose certifikime profesionale për Oracle Database Administration Certified Professional, Oracle Certified Associate (OCA), Oracle Certified Professional (OCP), MS SQL Database Administration.

Përvoja e punës:

- Të ketë së paku tre (3) vite përvojë pune profesionale në administrimin e bazave në Oracle ose MS SQL.

Njohuritë e kërkuara:

- Njohuri në administrimin e bazave të të dhënave të bazuara në Oracle ose MS SQL;
- Njohuri në dizajnimin logjik dhe fizik të bazave të të dhënave;
- Aftësi të kryejë rregullime në performancën e bazave të të dhënave;
- Të jetë i aftë të ofrojë strategji gjatë zhvillimit të bazave të të dhënave;
- Njohuri në Power BI, SSRS ;
- Eksperiencë me ETL procese duke përdorur SSIS ose Pentaho.
- Shkathtësi në shkrimin e query të ndryshëm sipas nevojave dhe natyrës së punës;
- Njohuri të mirë të menaxhimit të të drejtave të shfrytëzuesve të bazave të të dhënave;
- Përvojë në migrime të bazave të të dhënave;
- Njohuri në performance tuning të bazave të të dhënave;
- Përvojë në T-SQL ose PL/SQL.

Njohja e gjuhëve te huaja:

- Rrjedhshmëri në të folur dhe në të shkruar të gjuhës shqipe dhe/ose serbe.
- Njohja e gjuhës angleze përparësi;

Të gjithë kandidatët duhet të dërgojnë dokumentet e mëposhtme:

- Formularin zyrtar të BQK-së për aplikim;
- Letrën përcjellëse (motivuese) ku theksohet interesimi për këtë pozitë;
- **Dëshmi mbi përvojën e punës** (kopjet e kontratave ose vërtetimeve nga punëdhënësi ose dokumente tjera relevante që shërbejnë për të dëshmuar pozitën e mbajtur dhe përvojën e punës, pa cenuar aktet relevante për mbrojtjen e të dhënave personale);
- **Raportin nga Fondi për Kursime Pensionale i Kosovës (Trusti)** për periudhën përkatëse, apo vërtetimin tatimor nga Administrata e Tatimore (ATK) kur raporti nga Trusti nuk aplikohet ligjërisht;
- Kopjet e diplomave, ndërsa diplomat e fituara jashtë Republikës së Kosovës duhet të jenë të njohura /nostrifikuara zyrtarisht nga ana e MASHT-it;
- Dëshmi mbi identitetin/kopja e letërnjoftimit që shërben për të vërtetuar shtetësinë e Kosovës.

Procedura e aplikimit:

- Afati i fundit për aplikim është **02 prill 2025**.
- Aplikimi mund të bëhet online (<https://hris.bqk-kos.org>) përmes faqes zyrtare të BQK-së ose përmes arkivit të BQK-së. Asnjë formë tjetër e aplikimit nuk do të merret parasysh.
- Formën e aplikacionit mund ta shkarkoni përmes faqes zyrtare : www.bqk-kos.org



RASPISIVANJE KONKURSA ZA SLOBODNO RADNO MESTO

Naziv radnog mesta: Viši administrator baze podataka
Rang: P05
Trajanje zapošljavanja: Na neodređeno vreme
Odeljenje: Informacione tehnologije i bezbednost
Odsek: Za upravljanje bazom podataka i aplikacijama
Izveštava: Rukovodioca Odeljenja za upravljanje bazom podataka i aplikacijama

Glavne dužnosti i odgovornosti:

- Upravlja bazama podataka za aplikacije izrađene u Odeljenju za informacione tehnologije;
- Planira kreiranje i održavanje baza podataka. Blisko sarađuje sa sistemskim administratorima tokom instalacije aplikacija koje se povezuju na baze podataka;
- Instalira nove verzije baza podataka i njihovih alata, kao i drugih alata neophodnih za pristup bazama podataka;
- Ocenjuje verzije baze podataka i alate za podršku kako bi se osiguralo da baza podataka radi u skladu sa standardima. U saradnji sa drugim administratorima i programerima aplikacija, planira ažuriranja sa minimalnim uticajem na rad sistema;
- Administrator baze podataka je takođe tačka kontakta sa tehničkom podrškom kompanije Oracle i Microsoft , kao i drugim kompanijama koje su razvile sisteme za CBK;
- Pisanje naprednih query za analizu i obradu podataka prema poslovnim potrebama.
- Popravlja različite probleme u bazama podataka, aplikacijama, komunikaciji između njih i drugim alatima koje prijavljuju korisnici;
- Nadgleda i, u slučaju problema, rešava probleme u komunikaciji između različitih baza podataka i aplikacija;
- Konfiguriše baze podataka za “*high availability*”;
- Planira, sprovodi i kontinuirano testira procedure za back up i restore baze podataka ;
- Upravljanje korisničkim pravima i bezbednosnim politikama kako bi se obezbedio siguran pristup.
- Tehnička podrška i dijagnostika problema sa bazom podataka kako bi se obezbedio nesmetan rad.
- Izvodi EOD (End of Day) posle završetka radnog vremena ;
- Takođe obavlja i druge dužnosti koje mu odredi rukovodilac.

Obrazovanje:

- Univerzitetska diploma iz računarstva, elektrotehnike ili matematike, ili profesionalni sertifikati za Oracle Database Administration Certified Professional, Oracle Certified Associate (OCA), Oracle Certified Professional (OCP), MS SQL Database Administration.

Radno iskustvo:

- Treba da ima najmanje tri (3) godine profesionalnog radnog iskustva u administraciji baza podataka u Oracle ili MS SQL.

Potrebna znanja:

- Poznavanje upravljanja bazama podataka zasnovanih na Oracle ili MS SQL;
- Poznavanje logičkog i fizičkog dizajna baze podataka;
- Sposobnost obavljanja regulisanja performansi baze podataka;
- Biti u stanju da obezbedi strategije tokom kreiranja baze podataka;
- Poznavanje Power BI, SSRS;
- Iskustvo sa ETL procesima koji koriste SSIS ili Pentaho.
- Veštine pisanja različitih query prema potrebama i prirodi posla;
- Dobro poznavanje upravljanja pravima korisnika baze podataka;
- Iskustvo u migracijama baza podataka;
- Znanje u tuning performansi baze podataka;
- Iskustvo u T-SQL ili PL/SQL.

Poznavanje stranih jezika:

- Tečno govorenje i pisanje albanskog i/ili srpskog jezika.
- Poznavanje engleskog jezika je prednost;

Svi kandidati moraju dostaviti sledeća dokumenta:

- Zvanični obrazac za prijavu CBK-a;
- Propratno pismo (motivacija) u kojem se navodi interesovanje za ovu poziciju;
- **Dokaz o radnom iskustvu** (kopije ugovora ili potvrde poslodavca ili druga relevantna dokumenta koja služe za dokazivanje funkcije i radnog iskustva, ne dovodeći u pitanje relevantne akte o zaštiti ličnih podataka);
- **Izveštaj Kosovskog penzionog štednog fonda (Trusta)** za relevantni period, ili poreska potvrda od Poreske administracije (PAK) kada izveštaj Trusta nije zakonski primenljiv;
- Kopije diploma, dok diplome stečene van Republike Kosovo moraju biti zvanično priznate/ nostrifikovane od strane MONT-a;
- Dokaz o identitetu/kopija lične karte koja služi za dokazivanje kosovskog državljanstva.

Procedura prijave:

- Rok za prijavu je **02 april 2025**.
- Prijava se može izvršiti onlajn (<https://hris.bqk-kos.org>) preko zvanične internet stranice CBK-a ili preko arhive CBK-a. Nijedan drugi oblik prijave neće biti razmatran.
- Obrazac za prijavu možete preuzeti preko zvanične internet stranice: www.bqk-kos.org



SHPALLJE E VENDIT TË LIRË TË PUNËS

Titulli i vendit të punës:	Administrator/e i/e Lartë i Sistemeve
Grada:	P05
Kohëzgjatja e punësimit:	me afat të pacaktuar
Departamenti:	Teknologjia e Informacionit dhe Sigurisë
Divizioni:	I Infrastrukturës dhe Operacioneve
I raporton:	Udhëheqësit të Divizionit të Infrastrukturës dhe Operacioneve

Detyrat dhe Përgjegjësitë Kryesore:

- Konfiguron, monitoron pajisjet në infrastrukturë të DTI, përfshirë serverë, storage, switch dhe pajisje tjera përcjellëse,
- Konfiguron, instalon, monitoron dhe mirëmban sistemet operative në serverë fizik dhe virtual,
- Konfiguron, instalon, monitoron dhe mirëmban sistemet me role të caktuara, siç janë: Active, Directory, Failover Clustering, File Server, MS Exchange Server, etj.
- Administron infrastrukturën e PKI, përfshirë menaxhimin e certifikatave,
- Konfiguron, instalon, monitoron dhe mirëmban replikimet e të dhënave dhe sistemeve në mes dy qendrave.
- Konfiguron, instalon, monitoron dhe mirëmban backup-ët e të dhënave dhe sistemeve.
- Shërben si nivel i dytë i trajtimit të incidenteve dhe problemeve tek të gjithë shfrytëzuesit e teknologjisë informative.
- Menaxhon infrastrukturën, duke përfshirë instalimet dhe shpërndarjen e azhurnimeve dhe ndryshimeve.
- Konfiguron, instalon dhe përditëson softuerët në baza të rregullta në serverët dhe kompjuterët e shfrytëzuesve.
- Bashkëpunon ngushtë me Administratorët dhe teknikët brenda Divizionit dhe me zyrtarët e Divizionit të Sigurisë së Informacionit dhe Vazhdimësisë së Punës.
- Trajton dobësitë në infrastrukturë, në aspekt të sigurisë dhe përcjellë log-ët e sigurisë
- Përcjell dhe aplikon standardet e sigurisë së informacionit
- Monitoron dhe mirëmban sistemin e printimit.
- Merr pjesë aktive në përgatitjet dhe planifikimet afatshkurta dhe afatgjata të TI.
- Mirëmban dokumentim të konfigurimeve, krijon procedura dhe manuale për të gjitha pajisjet dhe shërbimet për të cilat është përgjegjës.
- Detyra tjera që i caktohen nga përgjegjësit në hierarkinë e Departamentit të Teknologjisë Informative.

Edukimi:

- Diplomë universitare në fushënnë fushën e shkencave kompjuterike, elektroteknike apo matematikës ose certifikime përkatëse që lidhen me rolin e Administratorit, MCSE, MSCA, CompTIA Server+ ose certifikimet e përditësuara qe lidhen me rolin e administratorit te sistemeve.

Përvoja e punës:

- Të ketë së paku tre (3) vite përvojë pune profesionale në administrim të sistemeve dhe sisteme operative Windows Server 2019, 2022.

Njohuritë e kërkuara:

- Njohuri në menaxhim të AD, DNS, DHCP, PKI, Windows Server Clustering.
- Njohuri ne Azure dhe Microsoft 365 është e preferueshme.
- Përvojë në sigurinë e sistemeve është e preferueshme.
- Përvoja në ambiente komplekse të infrastrukturës së TI e preferuar.
- Përvoja ose certifikim në ITIL i preferuar.

Njohja e gjuhëve te huaja:

- Rrjedhshmëri në të folur dhe në të shkruar të gjuhës shqipe dhe/ose serbe.
- Njohja e gjuhës angleze përparësi;

Të gjithë kandidatët duhet të dërgojnë dokumentet e mëposhtme:

- Formularin zyrtar të BQK-së për aplikim;
- Letrën përcjellëse (motivuese) ku theksohet interesimi për këtë pozitë;
- Dëshmi mbi përvojën e punës** (kopjet e kontratave ose vërtetimeve nga punëdhënësi ose dokumente tjera relevante që shërbejnë për të dëshmuar pozitën e mbajtur dhe përvojën e punës, pa cenuar aktet relevante për mbrojtjen e të dhënave personale);
- Raportin nga Fondi për Kursime Pensionale i Kosovës (Trusti)** për periudhën përkatëse, apo vërtetimin tatimor nga Administrata e Tatimore (ATK) kur raporti nga Trusti nuk aplikohet ligjërisht;
- Kopjet e diplomave, ndërsa diplomat e fituara jashtë Republikës së Kosovës duhet të jenë të njohura /nostrifikuara zyrtarisht nga ana e MASHT-it;
- Dëshmi mbi identitetin/kopja e letërnjoftimit që shërben për të vërtetuar shtetësinë e Kosovës.

Procedura e aplikimit:

- Afati i fundit për aplikim është **02 prill 2025**.
- Aplikimi mund të bëhet online (<https://hris.bqk-kos.org>) përmes faqes zyrtare të BQK-së ose përmes arkivit të BQK-së. Asnjë formë tjetër e aplikimit nuk do të merret parasysh.
- Formën e aplikacionit mund ta shkarkoni përmes faqes zyrtare : www.bqk-kos.org



RASPISIVANJE KONKURSA ZA SLOBODNO RADNO MESTO

Naziv radnog mesta:	Viši sistemski administrator
Rang:	P05
Trajanje zapošljavanja:	Na neodređeno vreme
Odeljenje:	Informacione tehnologije i bezbednost
Odsek:	Infrastruktura i operacije
Izveštava:	Rukovodioca Odseka za infrastrukturu i operacije

Glavne dužnosti i odgovornosti:

- Konfiguriše i nadgleda opremu u infrastrukturi DTI, uključujući servere, skladište, switch i drugu prateću opremu,
- Konfiguriše, instalira, nadgleda i održava operativne sisteme na fizičkim i virtuelnim serverima,
- Konfiguriše, instalira, nadgleda i održava sisteme sa određenim ulogama, kao što su : Active Directory , Failover Clustering, File Server , MS Exchange Server, itd.
- Upravlja PKI infrastrukturom, uključujući upravljanje certifikatima,
- Konfiguriše, instalira, nadgleda i održava replikaciju podataka i sistema između dva centra.
- Konfiguriše, instalira, nadgleda i održava backup-ove podataka i sistema.
- Služi kao drugi nivo upravljanja incidentima i problemima za sve korisnike informacionih tehnologija.
- Upravlja infrastrukturom, uključujući instalacije i distribuciju ažuriranja i promena.
- Konfiguriše, instalira i ažurira softvere na redovnoj osnovi na serverima i korisničkim računarima.
- Blisko sarađuje sa administratorima i tehničarima u okviru Odseka i sa zvaničnicima Odseka za bezbednost informacija i kontinuitet poslovanja.
- Rešava propuste u infrastrukturi, u smislu bezbednosti, i prati bezbednosnelog-ove
- Prati i primenjuje standarde bezbednosti informacija.
- Nadgleda i održava sistem štampanja.
- Aktivno učestvuje u kratkoročnim i dugoročnim IT pripremama i planiranju.
- Održava konfiguracionu dokumentaciju, kreira procedure i priručnike za svu opremu i usluge za koje je odgovoran.
- Ostali poslovi koje određuje odgovorni u hijerarhiji Odeljenja za informacione tehnologije.

Obrazovanje:

- Univerzitetska diploma iz oblasti računarstva, elektrotehnike ili matematike ili relevantni sertifikati u vezi sa ulogom administratora, MCSE, MSCA, CompTIA Server+ ili ažurirani sertifikati koji se odnose na ulogu administratora sistema.

Radno iskustvo:

- Treba da ima najmanje tri (3) godine profesionalnog radnog iskustva u upravljanju sistemima i Windows Server 2019, 2022 operativnim sistemima.

Potrebna znanja:

- Poznavanje upravljanja AD, DNS, DHCP, PKI, Windows Server Clustering.
- Poželjno je poznavanje Azure i Microsoft 365.
- Poželjno je iskustvo u oblasti bezbednosti sistema.
- Poželjno iskustvo u složenim okruženjima IT infrastrukture.
- Poželjno ITIL iskustvo ili sertifikacija.

Poznavanje stranih jezika:

- Tečno govorenje i pisanje albanskog i/ili srpskog jezika;
- Poznavanje engleskog jezika je prednost.

Svi kandidati moraju dostaviti sledeća dokumenta:

- Zvanični obrazac za prijavu CBK-a;
- Propratno pismo (motivacija) u kojem se navodi interesovanje za ovu poziciju;
- Dokaz o radnom iskustvu** (kopije ugovora ili potvrde poslodavca ili druga relevantna dokumenta koja služe za dokazivanje funkcije i radnog iskustva, ne dovodeći u pitanje relevantne akte o zaštiti ličnih podataka);
- Izveštaj Kosovskog penzionog štednog fonda (Trusta)** za relevantni period, ili poreska potvrda od Poreske administracije (PAK) kada izveštaj Trusta nije zakonski primenljiv;
- Kopije diploma, dok diplome stečene van Republike Kosovo moraju biti zvanično priznate/ nostrifikovane od strane MONT-a;
- Dokaz o identitetu/kopija lične karte koja služi za dokazivanje kosovskog državljanstva.

Procedura prijave:

- Rok za prijavu je **02 april 2025**.
- Prijava se može izvršiti onlajn (<https://hris.bqk-kos.org>) preko zvanične internet stranice CBK-a ili preko arhive CBK-a. Nijedan drugi oblik prijave neće biti razmatran.
- Obrazac za prijavu možete preuzeti preko zvanične internet stranice: www.bqk-kos.org



Gjej PUNË

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë



www.facebook.com/gjejpuneshejte

RESTAURANT

SWISS TAVERNA

Tel: +377 45 400 156 +386 49 848 553

PRISHTINË

NJOFTIM

Njoftojmë të gjithë klientët se Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar “Pave Group” SH.P.K. me seli në Viti, ka marrë vendim të shuajë biznesin me nrb. 812091908 dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditorë - Debitorë në këtë korporatë që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

OBAVESTENJE

Obavestavanje se svi klienti da drustvo sa “Pave Group” D.O.O. Viti, donelo odluku o prestani rada sa nrb. 812091908 ujedno imenovao Likvidatora o sprovođenju postupka likvidacije. Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze i potraživanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanja o novine.

ANNOUNCEMENT

We inform all customers that the limited liability “Pave Group” L.L.C. with headquarters Viti, has come to the decision to quit its business: 812091908 the company has appointed a liquidator who is going to oversee the liquidator process. All clients who have the mortgage – mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement- publication.

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

- Faik Ispahiu shpall të pavlefshme diplomën e nivelit Bachelor të lëshuar më datën 20.05.2003, nr.79 në degën e artit dramatik, drejtimi regjisor, në Fakultetin e Arteve në Universitetin e Prishtinës. Diploma është lëshuar nga UNMIK-u dhe UP-ja.

- Edon Thaqi nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e shkollës së mesme “Kadri Kusari”, Gjakovë.

- Istref Hysni Nebiu shpall të pavlefshme Diplomën e Inxhinier i Diplomuar i Makineris në UB-me nr. 332.

- Shkendije Lushaj nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e sh.m.l.m.”Hysni Zajmi” Gjakovë.

- Maurita Koca nga Bishtazhina KK Gjakovë shpall të pavlefshme dëftesën e kl.10 të Gjmnazit “Hajdar Duishi” Gjakovë.

- Bedri Zeneli nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesat e kl. 10.11.12 dhe diplomën dhe certifikatën e notave të Gjmnazit “Hajdar Dushi” Gjakovë.

- Lëshoj banesën me qira ne lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.

- Lëshoj banesën me qira, e cila gjendet prapa AAK-së, me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm.

- Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e telefonit: 044-162-783.

- Lëshohet banesa me qira ne qendër të Prishtinës afër Sheshit Zahir Pajaziti, banesa është dy dhomshe e mobiluar, lëshohet me qira prej 1 qershori deri me 1 gusht (dy muaj), çmimi sipas marrëveshjes. Për informata në tel. 044/171-328.

- Lëshoj banesën e re me qera në qendër prapa teatrit Kombëtar, me sipërfaqe prej: 60 m2. Banesa ka një dhomë gjumi, sallon dhe kuzhinë. Ka të gjitha pajisjet. Çmimi: 300 €uro. Banesa lëshohet për afate të gjata dhe të shkurtra. Informata në tel: 049\44-888-801 (viber)

- Lëshoj banesë me qira, pent-house. Banesa gjendet te Rrethi i Veternikut në Prishtinë. Banesa ka 150 m2, dhe ka 3 dhoma, dy banjo, 2 garazha si dhe shpajz. Për info mund të na kontaktoni në këtë nume të tel: 049-440-466.

Lume's Details
Estetik & Depilim

044 900 978 | 045 681 898

Sallon Depilimi Lume's Details

lumesdetails

Mbrapa Teatrit, 4 Lullat, Rr. Bajram Kelmendi

MEKA
HALAL FOOD

TRADITË QË NGA 1992







ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comercio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

